



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2025

VENDIM

Nr. 23, datë 22.01.2025

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR
PERIUDHËN 2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHENAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rendësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhe gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes apo natyrës së çështjes (civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale gjatë fazës së ekzekutimit) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e arsytimit të vendimit në emrtimin “Rrethanat e Faktit”.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në cilën përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) kërkesën e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar;¹ (ii) aspektet procedurale të seancës paraprake, njoftimit dhe prezencës së palëve,² etj. Në një nga çështjet familjare objekt shqyrtimi (zgjidhje martesë), referuar natyrës së vendimit,

¹ Vendimi nr. 144, datë 24.07.2017; Vendimi nr. 121, datë 12.06.2017; Vendimi nr. 6, datë 23.01.2018
Vendimi nr. 207, datë 22.07.2019

² Vendimet penale me objekt “Dergim në gjyq i procedimit penal”

gjqtarja është ndalur vetëm në pasqyrimin dhe analizën e fakteve me natyrë procedurale, që lidhen me të drejten e pales paditëse për të për të disponuar mbi padine konform nenit 201 të KPrCvile, përcaktuar kjo nga natyra e vendimit gjyqësor, i cili është vendim për pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak të heqjes dore nga gjykimi i çështjes.³

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit (*penale, civile ose familjare*) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë, si: procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar apo i zakonshëm në çështjet penale*), zhvillimi i gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje përgjithësisht të titulluar "*Rrethanat e faktit*" / "*Rrethanat e faktit të konstatuar gjate hetimit gjyqësor*", duke i parashtruar ato në mënyrë të qartë, në një rend kronologjik dhe logjik dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat gjyqtarja konkludon lidhur me provueshmërinë e fakteve konkrete. Në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me paraqitjen dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtares lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

- Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale (*gjykim themel, hetim paraprak apo seancë paraprake*). Gjyqtarja, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile detyrimi, njohje e vërtetësisë së dokumentit, kundërshtim veprimesh përmbartimore*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën procedohet në çështjet penale, apo seancën paraprake kur jemi para një kërkesë dërgim në gjyq.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar ligjin e zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes. Në disa nga vendimet të natyrës civile gjyqtarja tregon kujdes të vecantë në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm duke referuar dispozitat e ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës padisë .

³Vendimi nr.448 datë 07.09.2017

Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet civile/familjare, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si me poshtë:

- nenet 35/3, 36, 50 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me juridiksionin, kompetencën dhe përbërjen e gjykatës, nenet 175 dhe 179 të Kodit të Procedurës Civile përsa i përket zhvillimit të gjykimit në mungesë të palës së paditur;⁴
- nenet 14 dhe 223 të Kodit të Procedurës Civile për marrjen e provave nga të tretët në kuadër të detyrimit ligjor të gjykatës për të kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile përsa i përket saktësimin të objektit të padisë, nenin 31/13 dhe 32 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me të drejtën e padisë, nenin 610 dhe 613 të këtij Kodi në lidhje me kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor dhe kërkimin e sendit nga personi i tretë, nenin 106 të këtij Kodi, lidhur me shpenzimet gjyqësore;⁵
- nenet 175 dhe 179 përsa i përket zhvillimit të gjykimit në mungesë të personit të tretë; nenin 96 lidhur me përfaqësimin e palëve; nenin 160 në lidhje me shqyrtimin e kundërpadisë; nenin 224/a në lidhje me marrjen e provës me ekspert; nenin 201 dhe 299 lidhur me kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi dhe pushimin i çështjes; nenet 246-248 në lidhje me provat shkresore; nenin 12 në lidhje me barrën e provës; neni 308, 443, 444, në lidhje me shpalljen e vendimit dhe të drejtën e ankimit; si dhe nenin 106 lidhur me shpenzimet gjyqësore⁶
- nenet 31 dhe 32 të këtij Kodi në lidhje me të drejtën për të ngritur padi⁷
- nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile sa i përket barres se proves⁸
- nenin 299 të Kodit të Procedurës Civile, për pezullimin e gjykimit⁹
- nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, për lejimin e provës me ekspert. Citon nenin 308 të këtij Kodi lidhur me shpalljen e vendimit të gjykatës, nenin 443 dhe 444, në lidhje me të drejtën e ankimit¹⁰
- nenet 35/3 dhe 36 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 12 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës; nenin 14 dhe 19 të këtij ligji lidhur me aspektet procedurale të zhvillimit të gjykimit;¹¹
- nenin 201 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi dhe pushimin e çështjes; nenin 299, gërma “c” të këtij Kodi lidhur me rastet e pushimit të çështjes; nenin 127 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me natyrën e vendimit të pushimin (jo përfundimtar); nenin 300, lidhur me faktin se vendimi i pushimit nuk përbën gjë të gjykuar dhe i paditësi ka të drejtë ti drejtohet Gjykatës me

⁴Vendimi nr.325 date 18.12.2018; vendimi nr. 156/693 date 01.07.2019;; vendimi nr. 451 date 12.09.2017; vendimi 206 date 02.05.2019; vendimi 82 date 26.02.2018; vendimi 516 date 16.10.2017; vendimi 198 date 15.05.2018; vendimi 23 date 31.05.2019; vendimi 323 date 13.05.2019;

⁵Vendimi nr.325 date 18.12.2018; vendimin nr. 206, datë 02.05.2019

⁶ vendimi nr. 156/693 date 01.07.2019

⁷Vendimi nr. 451, datë 12.09.2017;

⁸Vendimi nr. 82, datë 26.02.2018

⁹Vendimi nr. 516, datë 16.10.2017

¹⁰Vendimi nr. 198, datë 15.05.2018

¹¹Vendimi nr. 57 Akti, nr. Vendimi s'ka datë 08.08.2019

të njetën kërkesëpadi si dhe nenin 301 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit¹²

- nenet 25 dhe 158/a të K.Pr.Civile në lidhje me nenin 134 të K.Familjes, në lidhje me ecurinë procedurale të çështjes, zhvillimin e veprimeve paraprake dhe seancës së pajtimit¹³

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*seancës paraprake, gjykim themeli apo kërkesë penale në fazën e ekzekutimit*), apo ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale, si me poshtë:

- nenet 331, 332, 332/a, 332/b, 332/c, 332/dh, 332/e, 332/ë, 332/f, 332/gj të Kodit të Procedurës Penale, për sa i përket kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe seancës paraprake. Gjithashtu referohet edhe neni 400 i Kodit të Procedurës Penale, lidhur me rastet e gjykimit të drejtëpërdejtë, neni 13 pika 2/ç lidhur me përbërjen e trupit gjykues; neni 327 i këtij Kodi lidhur me veprimet e prokurorit në përfundim të hetimeve¹⁴
- referon nenet 69, 13/2/ë për sa i përket juridikisionit dhe kompetencës së gjykatës dhe citohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, nenet 494/3 për sa i përket juridikisionit, kompetencës dhe përbërjes së gjykatës¹⁵
- nenet 512, 513, 514, 516, për sa i përket paraqitjes së kërkesës, kushtet që duhet të plotësojë një vendim për t'u njohur dhe ekzekutuar, gjykimi i kërkesës dhe vendimi i gjykatës në njohjen e vendimin penal të huaj; Citohen dispozitat e ligjit nr.10193 datë 03.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja në çështjet penale", nenet 53, 54, 55, 60 të tij, për sa i përket paraqitjes së kërkesës së njohjes së vendimit penal të huaj dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet asaj, kushtet për t'u njohur dhe ekzekutuar ky vendim, përveç atyre të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ekzekutimi i këtyre vendimeve etj; nenin 3 dhe 11 të ligjit nr. 8499 datë 10.06.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për transferimin e personave të dënuar", për sa i përket kushteve të transferimit dhe konvertimit të dënimit;¹⁶
- referohet neni 8 i Konventës së Këshillit të Europës mbi ekstradimin, në lidhje me refuzimin e ekstradimit; citohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, nenet 488, 489, 491, 497, 498 dhe 500, për sa i përket paraqitjes së kërkesës për ekstradim, kushteve ndaluese për mitratimin e ekstradimit; vendimi i gjykatës për lejimin e ekstradimit dhe pezullimi i ekstradimit; Citohen dispozitat e ligjit nr.10193 datë 03.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja në çështjet penale", nenet 32, 37, 39 të tij, për sa i përket, kushtet për lejimin e ekstradimit, përveç atyre të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale dhe shqyrtimi gjyqësor i kërkesës etj.¹⁷
- nenin 48, 54 dhe 348 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me të drejtën e mbrojtjes të të pandehurve. Nenin 367 të këtij Kodi, në lidhje me marrjen e provave të reja. Citon

¹²Vendimi nr. 448, datë 07.09.2017

¹³Vendimi 202, datë 17.05.2018

¹⁴Në të gjitha vendimet penale me objekt "Dërgim i çështjes në gjyq"

¹⁵Në të gjitha vendimet penale themeli

¹⁶Vendimi nr. 120 Akti date 19.09.2017

¹⁷Vendimi nr.26 date 28.03.2018

nenin 485 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me shpenzimet e fazës së hetimit paraprak dhe ato gjyqësore.¹⁸

- nenin 69, 470 dhe 477 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 71 të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” në lidhje me përbërjen, juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës për lirin me kusht;¹⁹
- nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale²⁰ në lidhje me kërkesën dhe vendimin për gjykimin e shkurtuar. Citon nenin 190 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me disponimin për provat materiale dhe nenin 485 të këtij Kodi lidhur me shpenzimet e fazës së hetimit paraprak dhe ato gjyqësore;²¹
- nenin 485 të këtij Kodi lidhur me shpenzimet e fazës së hetimit paraprak dhe ato gjyqësore nga ana e gjyqtarës citohet në të gjitha vendimet penale themeli
- nenin 63 dhe 72 të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998, lidhur me iniciimin e kërkesës për ulje dënimi dhe praninë e kërkuarit në seancë gjyqësore²².
- nenin 152 të Kodit të Procedurës penale në lidhje me çmuarjen e provave. Citon nenin 284 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale mbi ankimin e viktimës²³.
- Citon nenin 190 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me disponimin për provat materiale, nenin 393 të këtij Kodi lidhur me shpenzimet e fazës së hetimit paraprak dhe ato gjyqësore dhe nenin 386 dhe 415 lidhur me afatin e ankimit²⁴.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, i cili gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori:(i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

Në vendimet civile (me objekt kundërshtim veprimesh përmbare, zgjidhje martese, njohje e vërtetësie dokumenti, njohje e vjetërsisë në punë, përmbushje e detyrimit kontraktor, lëshim urdher ekzekutimit etj.) gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Familjes, ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, kryesisht në lidhje me:

- *Kundërshtimin e veprimeve përmbare, Identifikon dispozitat materiale të zbatueshme:* Citon nenin 92 të Kodit Civil, në lidhje me veprimet juridike të pavlefshme; nenin 419 të këtij Kodi në lidhje me përkufizimin e detyrimit; nenin 659 në lidhje me përkufizimin e kontratës; gjyqtarja identifikon dispozitën ligjore materiale dhe procedurale nenin 610 të K.Pr.Civile në lidhje me normën ligjore të zbatueshme

¹⁸Vendimi nr.168 date 30.07.2018

¹⁹Vendimi nr.52 akti date 03.07.2019

²⁰ Ne të gjitha vendimet penale themeli me të cilin është procedura me gjykim të shkurtuar

²¹ Vendimi nr. 144 date 24.07.2017

²² Vendimi nr. 253 akti date 10.05.2018

²³ Vendimi nr. 6 date 23.01.2018

²⁴ Vendimi nr. 207 vendimi date 22.07.2019

- për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm;²⁵
- *Lidhur me padinë e leshimit të urdhrimit të menjhershëm të mbrojtjes* gjyqtarja citon nenet 3, 4, 13, 15, 17, 19 të ligjit 9669/2006, lidhur me lëshimin e urdhrimit të menjhershëm të mbrojtjes; Citon Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.”, dhe Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”²⁶
 - *Lidhur me padinë njohjes pronar dhe lirim dorezim sendi*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 1162, 1163 dhe 169 në lidhje me hyrjen në fuqi të Kodit Civil, dispozitat tranzitore në lidhje me parashkrimin fitues dhe kuptimin e parashkrimit fitues pa titull, veprimet juridike të pavlefshme; nenin 163 në lidhje me mënyrat e fitimit të pronësisë; nenin 296 në lidhje me padinë e rivendikimit nenet 297-301 në lidhje me posedimin me mirëbesim dhe keqbesim dhe detyrimin e poseduesit të paligjshëm për të shpërblyer dëmin, apo kërkimin e frutave dhe shpenzimeve etj.²⁷
 - *Lidhur me pavartetësinë e pjeshme të dokumenteive të fletës së rregjistrimit*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenin 32/c të K.Pr.Civile lidhur me njohjen e vertetësisë apo pavartetësisë të një dokumenti me pasoja juridike;²⁸
 - *Permbushje detyrimi kontraktor*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm dispozitat materiale nenet 419, 659, 662, 698 të Kodit Civil, lidhur me përkufizimin e detyrimit dhe kontratës dhe të drejta dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata²⁹
 - *Njohje pronar me parashkrim fitues* gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm dispozitat materiale nenet 1162, 1163 dhe 169 në lidhje me hyrjen në fuqi të Kodit Civil, dispozitat tranzitore në lidhje me parashkrimin fitues dhe kuptimin e institutit të parashkrimit fitues pa titull; nenin 163 në lidhje me mënyrat e fitimit të pronësisë; Citon nenin 170 të Kodit Civil, lidhur me regjistrimin e pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme.³⁰
 - *Ndryshim i pjeshëm i vendimit dhe kthim në natyrë të pronës*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet Citon nenet 142 dhe 145 të Kodit Civil, në lidhje me kategorizimin e sendeve në të luajtshme dhe të paluajtshme. Citon parashikimet e ligjit nr.133/2015 në lidhje me trajtimin e pronës,³¹
 - *Në kërkesën për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit*, referohet neni 510, 511 të K.Pr.Civile.³²
 - *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*, gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare nenin 134 të Kodit të Familjes në lidhje seancën e pajtimit; nenin 155/1 të Kodit të Familjes në lidhje me caktimin e një eksperti psikolog; nenin 50/2 të Kodit të Familjes në lidhje me martesën dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj; nenin 132 të Kodit të Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort; nenin 138 të Kodit të Familjes në lidhje me detyrimin për ushqim

²⁵Vendimi nr. 325 date 18.12.2018; vendimi nr. 206 date 02.05.2019; vendimi nr.323 datë 13.05.2019

²⁶Vendimi nr. 57 Akti date 08.08.2019

²⁷ Vendimi nr. 156/693 akti datë 01.07.2019

²⁸ Vendimi nr. 451 datë 12.09.2017

²⁹ Vendimi nr. 82 datë 26.02.2018

³⁰ Vendimi nr. 516 datë 16.10.2017

³¹ Vendimi nr. 198 datë 15.05.2018

³² Vendimi nr. 236 datë 31.05.2019

ndaj fëmijës së mitur; nenin 146/1 të Kodit të Familjes në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës përsa i përket mbiemrit të bashkëshortit.³³

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Familjes si me sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si me poshtë:

- *Referon vendimet unifikuese:* Vendimin nr. 04, datë 10.12.2013 dhe nr. 03, datë 28.04.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me juridiksionin, dhe kompetencën e gjykatës.
- *Identifikon dispozitat konventore dhe kushtetuese,* duke cituar nenin 1 protokollin 1 i Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe nenin 41 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e pronës. Citon nenin 17 të Kushtetutës lidhur me të drejtat minimum që duhet të garantohen nga ligjvënësi.
- *Referon jurisprudencën e Gjykatës së Stasburgut dhe Gjykatës Kushtetuese:* Citon vendimet e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut, të tilla si: çështja *Sporrong dhe Lonroth kundër Suedisë*, viti 1982, çështja *Beshiri etj., kundër Shqipërisë*, viti 2006 dhe vendimin nr.1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese,³⁴

Në vendimet penale, gjyqtarja {...} {...}, identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit si dhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, si me poshtë:

- nenin 278/2 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale të «Mbajtje paligjshme e armëve luftarake dhe municionit» që i korrespondon vendimi penal i huaj në legjislacionin penal shqiptar «Prodhim dhe mbajtje pa leje e armës luftarake dhe municionit»³⁵;
- citohet neni 11 i Kodit Penal, në lidhje me kushtet për lejimin e ekstradimit; referohen nenet 283/a dhe 333/2 të Kodit Penal, dispozitat që i korrespondojnë legjislacionit penal shqiptar, në raport me ato të shtetit të huaj ku është dënuar personi që kërkohet të ekstradohet.³⁶
- cituar nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me veprën penale të shpërdorimit të detyrës, për të cilën akuzohen të pandehurit. Referon kuadrin ligjor në bazë të të cilit ka lindur dhe është themeluar marrëdhënia e punës së të pandehurve, si dhe dispozitat materiale në lidhje me caktimin dhe individualizimin e dënimit, neni 47, 48, 49 dhe 50 të Kodit Penal. Citon nenin 47 të Kodit Penal në lidhje me caktimin e dënimit, si dhe nenin 59 dhe 63 të Kodit Penal, në lidhje me pezulimin e vendimit të dënimit me burgim, vënien në provë dhe kryerjen e një pune për interes publik.³⁷
- nenet 64 dhe 65 të Kodit Penal, në lidhje me kushtet që duhet të plotësojë i dënuari për t'u liruar me kusht.³⁸

³³ Vendimi nr. 202 date 17.05.2018

³⁴ Vendimi nr. 198 date 15.05.2018

³⁵ Vendimi nr. 102 date 19.09.2017

³⁶ Vendimi nr. 26 date 28.03.2018

³⁷ Vendimi nr. 168 date 30.07.2018

³⁸ Vendimi nr. 52 Akti date 03.07.2019

- neni 199/a i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale penale “Ndërtim i paligjshëm”, për të cilën akuzohet i pandehuri. ³⁹
- neni 283/1 lidhur me veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve“ dhe neni 301 të Kodit Penal, në lidhje me veprat penale të “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”. ⁴⁰
- neni 130/a/4 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri «Dhune në familje » ⁴¹Citon nenin 278 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”. Citon nenin 47 të Kodit Penal në lidhje me caktimin e dënimit⁴²
- nenin 159/1 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit”. Citon nenet 47-50 të Kodit Penal në lidhje me caktimin e dënimit. Citon nenin 63 të Kodit Penal në lidhje me pezullimin e vendimit me burgim dhe kryerjen e një pune për interes publik⁴³
- nenin 273 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Largimi nga vendi i aksidentit”. Citon nenin 89 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “Plagosje e lehtë” dhe nenin 290/1, në lidhje me veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”. Citon nenin 90 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje”. Citon nenin 47 dhe 55 të Kodit Penal dhe neni 406 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me caktimin e dënimit.⁴⁴
- neni 284/1 i Kodit Penal, lidhur me veprën penale të Kultivim i bimeve narkotike” për të cilën akuzohet i pandehuri dhe personi nën hetim. ⁴⁵
- nenin 324/a/1 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”. VKM 303 date 25.03.2009 i dryshuar me VKM nr. 187 datë 17.03.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 303 date 25.03.2009 të KM, “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve“ konkretisht neni 21 i cili percakto sendet e ndaluara, citon nenin 47 dhe 55 të Kodit Penal dhe neni 406 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me caktimin e dënimit. Referon jurisprudencën Kushtetuese dhe atë të Gjykatës së Lartë: Citon vendimin nr.04, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë lidhur me gjykimin e shkurtuar. ⁴⁶

Referohen dispozita pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me analizën e elementëve të figurës së veprës penale si dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (nenin 47 të K. Penal) dhe bashkimin e dënimeve kur është rasti (nenin 55 i K. Penal); rrethanat lehtësuese dhe rënduese (nenet 48, 49 dhe 50 të K. Penal); dispozitat lidhur me dënimet alternative dhe pezullimin e vendimit (neni 59 dhe 63 të Kodit Penal); etj. Krahas dispozitave të Kodit Penal gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

³⁹ Vendimi nr. 567 Akti date 10.09.2019; vendimi 268 akti date 26.10.2017

⁴⁰ Vendimi nr. 564 Akti date 23.09.2019

⁴¹ Vendimi nr. 491 Akti, nr. Vendimi s'ka, datë vendimi 20.09.2018

⁴² Vendimi nr. 144, datë 24.07.2017

⁴³ Vendimi nr. 121 date 06.07.2017

⁴⁴ Vendimi nr. 6 date 23.01.2018

⁴⁵ Vendimi nr. 23/394 date 08.02.2018

⁴⁶ Vendimi nr. 207 date 22.07.2019

- referon nenet 512 e vijues të Kodit të Procedurës Penale; ligji nr. 10193 datë 03.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja në çështjet penale"; ligji nr. 8499 datë 10.06.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për transferimin e personave të dënuar", ligjit nr. 9068 datë 15.05.2003 "Për ratifikimin e Konventës Europiane për vlefshmërinë ndërkomëtare të Gjykimeve penale"; Vendimet Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5 datë 10.10.2002, nr. 1 datë 30.01.2003, nr. 4 datë 27.03.2003 dhe nr. 154 datë 08.12.1999; për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje
- nenin 3 dhe 11 të ligjit nr. 8499 datë 10.06.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për transferimin e personave të dënuar", përsa i përket kushteve të transferimit dhe konvertimit të dënimit;
- *Referon jurisprudencën kushtetuese dhe atë të Gjykatës së Lartë*: Citon vendimin nr.04, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë në lidhje me gjykimin e shkurtuar, *Referon jurisprudencën kushtetuese dhe atë të Gjykatës së Lartë*: Citon vendimin nr.04, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë në lidhje me gjykimin e shkurtuar⁴⁷
- *vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015*, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka analizuar institutin e liritimit me kusht.⁴⁸
- *vendimet unifikuese*: vendimin nr.55 datë 10.10.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me transferimin e të dënuarve dhe vendimin unifikues nr.154 datë 08.12.1999/15.04.2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me shqyrtimin e çështjeve me objekt njohjen e vendimit penal të huaj.⁴⁹

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në një rast konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet ndonjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

KONKLUZIONI

Referuar sa me sipër gjyqtarja {...} {...} shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, i) si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë procedurale të çështjes dhe veprimeve të kryera së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve, ii) ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitikë, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Evidentohet aftësi shumë të mira të gjyqtarës në identifikimin e normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

⁴⁷ *Vendimi nr. 144, datë 24.07.2017*

⁴⁸ *Vendimi nr. 207 date 22.07.2019*

⁴⁹ *Vendimi nr. 120 Akti, nr. s'ka Vendimi, datë 19.09.2017*

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore me natyrë procedurale apo materiale, citohen ose referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Gjyqtarja i kushton vëmendje interpretimit të normave në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Për të identifikuar qëllimin e normës gjyqtarja përdor interpretimin *teologjik*, por edhe interpretimin *historik, literal* dhe *sistematik* të normave, duke e ballafaquar kuptimin e saj me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në vendimet civile përgjithësisht interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, duke e analizuar me pas normën në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë me specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se:

- Merr në analizë kundërshtimin e veprimeve përmbartimore duke e përcaktuar si një mjet mbrojtës kundër ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile. Interpreton nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile, duke analizuar se cilat janë veprimet e përmbartuesit gjyqësor që mund të kundërshtohen, duke përcaktuar se, ndër të tjera mund të kundërshtohen nëse ka pretendime në lidhje me: a) aktin në bazë të të cilit ka nisur procedura e ekzekutimit si psh kur pretendohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston apo ekziston në një masë me të vogël ose kur pretendohet se detyrimi është shuar; b) rrethana që pengojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv si psh kur veprimet përmbartimore janë duke u kryer ndërkohë që është vendosur pezullimi i tyre nga gjykata; c) rregullshmërinë e veprimeve konkrete që janë duke u realizuar nga përmbartuesi gjyqësor.
- Interpreton nenin 612 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me padinë e kundërshtimit të të tretit, duke arsyetuar se me anë të kësaj dispozite mbrohet personi i cili pretendon të drejta pronësie mbi një pasuri e cila i është nënshtruar procesit të ekzekutimit të detyrueshëm për shkak të mos përmbushjes/mosekzekutimit vullnetar

të detyrimit nga ana e debitorit. Qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e pasurisë së personit të tretë nga shitja apo sekuestrimi i pasurisë.⁵⁰

- Interpreton dispozitat materiale që gjejnë zbatim në çështjen objekt gjykimi, analizon teorikisht padinë e rivendikimit, duke interpretuar nenin, 296 të Kodit Civil, duke arsyetuar se në këtë dispozitë ligjvënësi ka rregulluar njërin prej mjeteve me kryesore e me të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, pikërisht padinë e rivendikimit e njohur në doktrinën juridike si padia e pronarit joposuedes kundër poseduesit jo pronar. Gjithashtu në këtë padi gjykata vlereson të bëjë gjithashtu interpretim dhe të dispozitave ligjore konkretisht neneve 1162, 1163 dhe 169 të Kodit Civil, sa i përket parashkrimit të padisë dhe parashkrimit fitues që kanë filluar para hyrjes në fuqi të Kodit Civil, por që nuk janë plotësuar sipas dispozitave të mërpashme, do të zbatohen këto të fundit, neni 1163. Gjyqtarja interpreton nenin 169 të Kodit Civil që lidhet me parashkrimin fitues pa tillull, njohja e së drejtës së pronësisë sipas kësaj dispozite kërkon plotësimin komulativisht të disa kushteve të percaktuara në këto dispozite.⁵¹
- Duke interpretuar nenet 419, 659, 652 të K. Civil, gjyqtarja merr në analizë natyrën e marrëdhënies juridike të detyrimit në përgjithësi; natyrën dhe formën e veprimeve juridike për efekt të vlefshmërisë ose provueshmërisë; kushtet thelbësore për ekzistencën dhe vlefshmërinë e marrëdhënies juridike të detyrimit; marrëdhënie juridike specifike që buron nga kontrata e huasë; formën e kontratës dhe rëndësinë e saj për vlefshmërinë ose provueshmërinë e marrëdhënies; konceptimin e faktit juridik krijues dhe shues; barrën e provës për subjektet e marrëdhënies juridike në lidhje me ekzistencën e këtyre fakteve; mospërmbushjen e detyrimit kontraktor si dhe pasojat që vijnë prej saj.⁵²
- Duke interpretuar dispozitat materiale, konkretisht neni 132 i K.Familjes, i cili ka sanksionuar shkaqet e zgjidhjes së martesës. Gjyqtarja interpreton dhe zbaton nenin 146 të K.Familjes në lidhje me ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortit tjetër si një ndër pasojat e zgjidhjes së martesës. Në vijim, në lidhje me zgjidhjen e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e martesës, për sa i përket mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (*lënies së fëmijëve të mitur për rritje*), gjyqtarja mban në konsideratë parimin e interesit me të lartë të fëmijës.⁵³

Në vendimet penale gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (*nenet 283/1, 324/a/1, 199/a, 284, 278/2, 130/a, 278 të Kodit Penal etj*) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkohet dërgimi në gjyq apo gjykimi i të pandehurit dhe të përcaktimit të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përqasur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.⁵⁴

⁵⁰Vendimi nr. 325 datë 18.12.2018

⁵¹Vendimi nr. 156/693 Akti datë 01.07.2019

⁵²Vendimi nr. 82 datë 26.02.2018

⁵³Vendim nr. 202 datë 17.05.2018

⁵⁴Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes

Përgjithësisht, dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen duke zbërthyer të katër elementët e figurës së veprës penale, por duke u përqendruar me tepër në anën objektive dhe subjektive të saj. Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit është një dispozitë *blankete*, (*neni 324/a/1 i Kodit Penal*)⁵⁵ gjyqtarja zbaton dhe në disa raste interpreton edhe dispozita të ligjeve të posaçme ku të referon fakti penal.

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast gjyqtarja interpreton *dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si me poshtë:

- Gjyqtarja interpreton dispozitat që lidhen me përcaktimin e *dënimit penal*, duke u ndalur në qëllimin e dënimit penal, individualizimin e tij (*nenet 47, 48, 49, 50 të K. Penal*), kushtet dhe kriteret ligjore që merren në konsideratë në caktimin dhe individualizimin e dënimit dhe rrezikshmërinë e autori, ndikimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese (*nenet 48,49,50 të Kodit Penal*), etj.⁵⁶
- Interpreton dispozitën materiale penale (*nenin 59 të K. Penal*), në lidhje me aplikimin e *alternativave të ekzekutimit të dënimit*, duke u ndalur kryesisht në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri një dënim alternativ, siç është ai i parashikuar në nenin 59 i Kodit Penal.⁵⁷
- Interpreton nenin 63 të K.Penal, në lidhje e aplikimin e alternativës së dënimit me burgim, kryerjen e punës për interes publik dhe orët e punës që do të kryhen.⁵⁸
- Interpreton zbatimin e nenit 54 të ligjit nr. 10193/2009, mbi faktet objekt gjykimi në lidhje me kushtet pozitive shtesë të përcaktuar në këtë nen;

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësi interpretimit të normës, si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake; në kërkesën penale për ulje dënimi, në çështjet në të cilat është vendosur pushimi i gjykimit, etj. Konkretisht:

- Në vendimet e kategorisë së çështjeve seancë paraprake (*dërgim në gjyq apo edhe kërkesë për pushimin e procedimit penal*), interpreton legjislacionin procedural penal lidhur me disponimin e prokurorit në përfundim të hetimeve paraprake. Kështu parashtrohet se prokurori në përfundim të hetimeve ka të drejtë të vendose pushimin e akuzës ose çështjes, ose të kërkojë në gjykatë pushimin e akuzës apo çështjes; i kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq; procedon sipas nenve 400, 406/a dhe 406/dh, që lidhen me gjykimin e drejtpërdrejtë.
- Në çështjet penale të themelit gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale nenet 403, 404 dhe 406 të K.Pr.Penale në mbështetje të argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.⁵⁹

⁵⁵Vendimi nr. 207 date 22.07.2019

⁵⁶Vendimi nr. 207 date 22.07.2019

⁵⁷Vendimi nr. 168, datë 30.07.2018

⁵⁸Vendimi nr. 121, datë 06.07.2017

⁵⁹ Në të gjitha vendimet penale të themelit ne te cilet është proceduar me gjykim të shkurtuar

- Në aspektin e zgjidhjes së çështjes në themel, gjyqtarja interpreton zbatimin e nenit 514 të Kodit të Procedurës Penale, mbi faktet objekt gjykimi, në lidhje me kushtet ndaluese për njohjen e vendimit penal të huaj. Merr në shqyrtim të gjitha kushtet e parashikuara në këtë nen për të konkluduar nëse në rastin objekt gjykimi konstatohet ekzistenca e ndonjëres prej tyre.⁶⁰;
- Interpreton nenin 489 të Kodit të Procedurës Penale dhe parashikimet e ligjit 10193/2009, në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqitet detyrimisht nga autoriteti i huaj në lidhje me kërkesat për ekstradimin.
- Analizon marrëdhënien juridike të detyrimit duke interpretuar nenin 419 të Kodit Civile. Marrëdhënia juridike civile e detyrimit përkufizohet si marrëdhënie pasurore ose jopasurore ku subjektet e së drejtës civile (*personat fizikë apo juridikë*) paraqiten si mbajtës të të drejtave subjektive dhe të detyrimeve juridiko civile. Kjo marrëdhënie mund të lindë për shkak të ligjit (*ipso lege*) ose për shkak të vullnetit. Kontrata me detyrime të dyanshme, si një veprim juridik i dyanshëm, është një nga format e krijimit të marrëdhënies juridiko-civile të detyrimit.⁶¹
- Merr në analizë kundërshtimin e veprimeve përmbarimore duke e përcaktuar si një mjet mbrojtës kundër ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile. Interpreton nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile, duke analizuar se cilat janë veprimet e përmbaruesit gjyqësor që mund të kundërshtohen, duke përcaktuar se, ndër të tjera mund të kundërshtohen nëse ka pretendime në lidhje me: a) aktin në bazë të të cilit ka nisur procedura e ekzekutimit si psh kur pretendohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston apo ekziston në një masë me të vogël ose kur pretendohet se detyrimi është shuar; b) rrethana që pengojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv si psh kur veprimet përmbarimore janë duke u kryer ndërkohë që është vendosur pezullimi i tyre nga gjykata; c) rregullshmërinë e veprimeve konkrete që janë duke u realizuar nga përmbaruesi gjyqësor.
- Interpreton nenin 612 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me padinë e kundërshtimit të të tretit, duke arsyetuar se me anë të kësaj dispozite mbrohet personi i cili pretendon të drejta pronësie mbi një pasuri e cila i është nënshtruar procesit të ekzekutimit të detyrueshëm për shkak të mos përbushjes/mosekzekutimit vullnetar të detyrimit nga ana e debitorit. Qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e pasurisë së personit të tretë nga shitja apo sekuestrimi i pasurisë⁶².
- Në çështjen me objekt "*Njohje e vërtetësisë së dokumentit*" gjyqtarja merr në analizë padinë e njohjes, sipas nenit 32/c të K.Pr.Civile.⁶³

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si me poshtë:

⁶⁰ Vendimi me nr.120 Akti, nr. s'ka Vendimi, datë 19.09.2017

⁶¹Vendimi nr. 82 date 26.02.2018

⁶²Vendimi nr.325 datë 18.12.2017

⁶³Vendimi nr.451 date 12.09.2017

- nenin 3 dhe 11 të ligjit nr. 8499 datë 10.06.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për transferimin e personave të dënuar", përsa i përket kushteve të transferimit dhe konvertimit të dënimit;
- *Referon jurisprudencën kushtetuese dhe atë të Gjykatës së Lartë*: Citon vendimin nr.04, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë në lidhje me gjykimin e shkurtuar⁶⁴
- *vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015*, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka analizuar institutin e lirit me kusht.⁶⁵
- *vendimet unifikuese*: vendimin nr.55 datë 10.10.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me transferimin e të dënuarve dhe vendimin unifikues nr.154 datë 08.12.1999/15.04.2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me shqyrtimin e çështjeve me objekt njohjen e vendimit penal të huaj.⁶⁶
- *vendimet me nr. 3508* date 18.09.2014 ; nr. 2132 datë 25.06.2014 ; nr. 2208 date 23.07.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë lidhur me percaktimin dhe natyrën e çështjes objekt gjykimi kur shkak i padisë dhe kerkimet e padisë kanë natyrë civile.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet përgjithsisht jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, *si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të humanizmit, përshtatshmërisë së llojit dhe masës së dënimit (neni 47,1/b dhe 1/c i K. Penal)*, të cilat referohen dhe analizohen me pas në raport me rrethanat konkrete të çështjes.
- *Parimi i veprimit të ligjit penal në kohë*, duke analizuar normën penale (nenin 278/1 të K.Penal) sipas ligjit të kohës kur ka ndodhur vepra penale
- *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine legge*, i referuar dhe po ashtu i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në vendimet penale të themelit dhe ato të seancës paraprake.
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës)* si dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke iu referuar aspektit procedural të gjykimit që lidhet me të drejtën e mbrojtjes;
- *Parimin e interesit me të lartë moral dhe material të fëmijëve të mitur*, duke cituar për këtë qëllim neni 2 të K.Familjes, dispozita të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”, Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Në këtë vendim, në kuadër të analizës lidhur me të drejtën për martesë, të drejtën për jetë private dhe familjare, gjyqtarja referon parimin e autonomisë së vullnetit të palëve në lidhjen e martesës.
- *Parimin e disponibilitetit të padisë në drejtim të vlerësimit të së drejtës së paditësit për*

⁶⁴ Vendimi nr. 144, datë 24.07.2017

⁶⁵ Vendimi nr. 207 date 22.07.2019

⁶⁶ Vendimi nr. 120 Akti, nr. s'ka Vendimi, datë 19.09.2017

të iniciuar një proces gjyqësor edhe të drejtën e palës incizuese për të disponuar në lidhje me padinë e paraqitur prej saj.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdes i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Mënyra e të shkruarit të vendimit gjyqësor, me një strukturë të qëndrueshme, me fjali të thjeshta dhe të qarta, e bën atë të lehtë për t’u identifikuar dhe të thjeshtë për t’u kuptuar. Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa), duke u shoqëruar gjithmonë me dhenien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.⁶⁷ Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit,⁶⁸ përdorimi i termave teknike është pothuajse tërësisht i kufizuar, pasi gjyqtarja është kujdesur që shpjegimin e tij ta formulojë në një gjuhë me të theshtë dhe gjithashtu kuptimi del qartë nga konteksti i arsyetimit.

⁶⁷P.sh: *ipso lege, animus dominandi, a priori, ne bis in idem etj.*

⁶⁸ Vendimi nr.198 date 15.05.2018; vendimi nr. 202 date 17.05.2018

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare (*me objekt zgjidhje martesë*), evidentohet kujdesi i gjyqtarës për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të pretendimeve nga palët, në respektim të parimit të interesit me të lartë të fëmijës dhe të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.⁶⁹

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhenë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhe logjike të njëra-tjetrës, paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali me të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi. Në çdo rast mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhe logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar në shumicën e vendimeve me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit.

KONKLuzioni

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...} {...} i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhenë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, së

⁶⁹ Vendimi nr. 202 date 17.05.2018

cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe atyre thelbësore, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë si pasojë e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, përgjithësisht të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejmë pasqyrim të dhenat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat kryesisht janë të listuar formalisht me tituj, duke orientuar qartë lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek kryesisht këtë renditje:

- (i) *Rrethanat e faktit* duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes, si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, etj. Në këtë pjesë evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.
- (ii) *Pretendimet e palëve* ndergjyqese të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në një paragraf .
- (iii) *Dispozitat ligjore të zbatueshme/ Analiza juridike* ku gjyqtarja përveçse referon, citon përmbajtjen dhe merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin abstrakt të tij, para aplikimit mbi faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai me natyrë procedurale ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij. Në ndonjë rast, gjyqtarja para arsytimit ligjor, ka referuar dhe cituar në një nënndarje me vetë dispozitat e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, të cilat me pas integrohen në arsyetim.⁷⁰
- (iv) *Në lidhje me të drejtën e ankimit dhe shpenzimet gjyqësore*, pjesë në të cilën gjyqtarja, në mënyrë të zgjeruar referon dhe citon nënkatëgoritë duke cituar gjithashtu përmbajtjen e dispozitës dhe afatet në lidhje me të drejtën e ankimit dhe shpenzimet gjyqësore.

Në pjesën e dispozitivit gjejmë pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejmë pasqyrim disponimi i gjykatës mbi padinë e ngritur (*pranimin apo rrëzimin e kërkesës padisë*), ai në lidhje me përgjegjësinë

⁷⁰ Në të gjitha vendimet penale me objekt " dërgim e gjyq"

penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet, mënyra e disponimit për çështjet specifike të seancës paraprake (*për dërgimin e çështjes në gjyq ose kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve*), caktimin e dënimit, masën e tij si dhe kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet në dispozitiv e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale të themelit.

KONKLUZIONI

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, në tërësi evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake; procedimit me gjykim të shkurtuar, etj.

Arsytimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil /penal), duke bërë një analizë tërësore të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Dispozita ligjore zërthehet dhe interpretohet në kuptimin abstrakt, dhe vijon të aplikohet mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të zgjidhjes së çështjes. Gjyqtarja gjate arsytimit tregon kujdes të vecantë sa i përket mënyrës së organizimit të vendimit për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes dhe zgjidhjen e çështjes në themel.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit/çështjes, orienton analizën juridike duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim.

Në vendimet civile burim vlerësimi gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh:

- (i) Analizon teorikisht institutin e veprimit juridik, duke u ndalur në perkufizimin e këtij instituti, dhe elementët e tij: subjektet e veprimit juridik, shfaqjen e vullnetit në kryerjen e veprimit juridik, si duhet të shfaqet vullneti që të përbëjë një veprim juridik të vlefshëm, shkaku dhe formën e veprimit juridik. Kështu, gjyqtarja arsyeton se veprimi juridik konsiston në një manifestim të drejtpërdrejtë të vullnetit me synimin për të arritur pasoja juridike të caktuara. Veprimi juridik sjell pasoja juridike në lidhje me të paktën një subjekt, i cili duhet të ketë zotësi juridike dhe zotësi juridike të plotë për të vepruar. Analizon shfaqjen e vullnetit në kryerjen e një veprimit juridike duke arsyetuar se në literaturën juridike identifikohet vullneti i brendshëm dhe ai i jashtëm. Për të arritur në konkluzionin nëse veprimi juridik është apo jo i vlefshëm duhet që të dy këto momente të koincidojnë në një të vetëm, pra vullneti i brendshëm të përputhet me atë të jashtëm. Njëkohësisht vullneti duhet të jetë i vërtetë, serioz dhe të jetë i drejtuar drejt synimit që shfaqet. Analizon shkaku e kryerjes së një veprimit juridik duke e perkufizuar si qëllimin tipik/qëllimi të drejtpërdrejtë, Gjithashtu arsyeton se forma është element thelbësor/esencial i veprimit juridik nisur nga kuptimi i nenit 79 të k.c, pra se vullneti duhet të shfaqet në botën e jashtme.⁷¹
- (ii) Në vendimin me objekt pafshmeri kontrate dhe kundërshtim veprimesh permbarimore analizohen kërkimet e palës paditëse duke interpretuar nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile, përse i përket institutit të barrës së provës, duke arsyetuar që pala që pretendon një të drejtë mbart dhe detyrimin ligjor për ta provuar atë.
- (iii) Institutit të zgjidhjes së martesës, format e zgjidhjes së saj, duke u ndalur në mënyrë me të detajuar në analizën e rastit konkret, atë me pëlqim reciprok të palëve. Pasojat ligjore që rrjedhin nga zgjidhja e martesës, duke u ndalur në këtë drejtim në pasojat në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në tre komponentë të saj: lënien e fëmijës për rritje dhe edukim; detyrimin për ushqim, si dhe të drejtën e takimit për prindin tjetër, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit me të lartë të fëmijës;⁷²
- (iv) Analizon institutin e kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore, duke arsyetuar se në rastin objekt gjykimi, gjykata pranoi kërkesën për shqyrtimin e kundërpadisë së bashku me padinë, duke vlerësuar se objekti i kundërpadisë ka lidhje të drejtpërdrejtë me atë të padisë pasi të dyja palët ndërgjyqëse pretendojnë të drejta pronësie mbi të njëjtën pasuri të paluajtshme⁷³.

⁷¹Vendimi nr. 325 date 18.12.2018

⁷²Vendimi nr. 202 date 17.05.2018

⁷³ Neni 160 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: « I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkitur i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi. »

- (v) Analizon institutin e pushimit të gjykimit duke interpretuar nenin 201 dhe 299 të Kodit të Procedurës Civile, duke arsyetuar se nisja e një procesi gjyqësor civil është një e drejtë ekskluzive e palës, e cila ka interesin të realizojë disa pasoja juridike të konkretizuara në objektin e kërkesës; Gjyqtarja fillimisht interpreton dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në çështjen objekt gjykimi, fillimisht jep konceptin e fitimit të pronësisë dhe analizon institutin e parashkrimit fitues pa titull si një nga mënyrat e fitimit të pronësisë. Analizon kushtet kumulative që duhet të plotësohen në mënyrë që një send të fitohet nëpërmjet parashkrimit fitues pa titull,⁷⁴
- (vi) Analizën e padisë së njohjes sipas parashikimeve të nenit 32/c të K.Pr.Civile, duke u ndalur në mënyrë të posaçme në çështje të interesit të ligjshëm, legjitimitetin të palës paditëse për ngritjen e kësaj padie, dhe duke vijuar me analizën e rrethanave konkrete të kërimit mbi vërtetësinë e të dhenave të pasqyruara në fletën e regjistrit të marrëdhënieve të punës;⁷⁵ etj.
- (vii) Analizon institutin e legjitimitetit procedural dhe real të palëve duke e përcaktuar i një detyrim të palës paditëse për të provuar: *së pari*, faktin se palët ndërgjyqëse janë palë në një marrëdhënie juridiko civile, pra pjesëmarrës të një Raporti materialo juridik, arsye për të cilën paditësi justifikohet ligjërisht të vërë në lëvizje Gjykatën. Po ashtu se personi i paraqitur gjatë gjykimit është përfaqësues i palës paditëse në kuptim të neneve 96 e vijues dhe 176 të K.Pr.Civile (*legjitimimi procedural ose legitimatio ad procesum*); *së dyti*, ekzistencën e interesit të tij aktual, të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm për mbrojtjen e një të drejte që pretendon se i është shkelur, cënuar apo mohuar nga pala tjetër ndërgjyqëse të cilën e thërret në gjykim (*legjitimimi real ose legitimatio ad causam*).⁷⁶

Në vendimet penale burim vlerësimi, karakteristikë e gjyqtarës është paraqitja dhe analiza e detajuar e fakteve të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë. Gjyqtarja integron në mënyrë të natyrshme faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural. Gjyqtarja ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit apo faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake. Në të gjitha vendimet penale themeli gjyqtarja trajton shkurtimisht institutin e dënimit penal, apo kur është rasti institutin e pezullimit të dënimit me burg.

Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, kryesisht në drejtim të :

⁷⁴Vendimi nr. 156/693 date 01.07.2019

⁷⁵Vendimi nr. 451 date 12.09.2017

⁷⁶Vendimi nr. 82 date 26.02.2018

- (i) figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet dhe elementëve e saj, si dhe autorësisë e të pandehurit;⁷⁷
- (ii) ecurisë procedurale të gjykimit në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar;
- (iii) analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të individualizimit të dënimit ;⁷⁸
- (iv) aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke analizuar kriteret ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për aplikimin e kësaj alternative.⁷⁹

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.). Pretendimet e palëve merren gjithmonë në shqyrtim dhe analizohen në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre. Ato integrohen natyrshëm në arsytimin tërësor të vendimit gjyqësor.

KONKLUZIONI

Sa më sipër referuar të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor - konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse pasi arsytimi të vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

⁷⁷ Në të gjitha vendimet penale të themelit apo edhe ato të seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq gjyqtarja ndalet në analizën e elementëve të figurës së veprës penale

⁷⁸Në të gjitha vendimet penale të themelit

⁷⁹Vendimi nr.121 date 06.07.2017

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë 820 çështje për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi, nga të cilat 162 çështje ose 19.7 % e tyre kanë përfunduar tej këtij afati.

Pavarësisht këtij Raporti të pasqyruar në Raportin Analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësim, referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe shpjegimeve të gjyqtarës në formularin e vetëvlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 820 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (237 çështje në vitin 2017, 274 çështje në vitin 2018 dhe 309 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë”, “Familjare me palë kundërshtarë”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe “Penale seancë parapake”.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhenat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhenat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhenat statistikore, për çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se :

Për vitin 2017,

- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 35, 61-63 dhe 65-70, me objekt “Lëshim urdher ekzekutimi”, janë gjykuar përkatësisht në afatin 34 ditë, 11 ditë, 11 ditë, 11 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 7 ditë, 6 ditë dhe 6 ditë, ndërkohë që referuar nenit 510 të K.Pr.Civile në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 5 ditë.⁸⁰
- Në tabelën nr. 10, çështjet me nr. rendor 62, 85 dhe 95, me objekt “Revokim / zëvendësim i masës së sigurimit”, janë gjykuar respektivisht në afatin 7 ditë, 7 ditë dhe 7 ditë, ndërkohë që neni 260 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 5 ditë, duke patur parasysh ngarkesën e lartë të gjyqtarës konsiderohet me një tejkalim të papërfillshëm prej dy ditësh.
- Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 14, me objekt “Dërgim çështje në gjyq”, janë gjykuar në afatin 34 ditë, me një tejkalim të papërfillshëm prej 4 ditësh ndërkohë që neni 332 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë.

⁸⁰Kërkesat e regjistruara para datës 07.11.2017, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

- Në tabelën nr. 12, çështja me nr. rendor 111, me objekt “Përjashtim gjyqtari”, është gjykuar në afatin 3 ditë, me nje tejkalim te paperfillshem prej ndërkohë që neni 22 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 48 orë.⁸¹

Për vitin 2018,

- Në tabelën nr. 3,⁸² çështjet me nr. rendor 4, me objekt “Sigurim padie”, janë gjykuar në afatin 6 ditë, papërfillshem prej 1 ditë ndërkohë që neni 202 i K.Pr.Civile, ka parashikuar afatin ligjor 5 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor vetëm me 1 ditë. Tejkalim ky i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit.
- Në tabelën nr. 10, çështjet me nr. rendor 15, me objekt “Caktim mase”, janë gjykuar në afatin 3 ditë, ndërkohë që referuar neneve 244 e vijues të K.Pr.Penale, i cili përcakton afatin ligjor i gjykimit 48 orë.⁸³ Kjo çështje rezulton e regjistruar me datë 27.11.2018 dhe ka përfunduar me datën 30.11.2018, vlerësohet i papërfillshëm tejkalimi i afatit, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit
- Në tabelën nr. 10, çështjet me nr. rendor 8, 11 dhe 12, me objekt “Revokim / Zëvendësim i masës së sigurimit”, janë gjykuar në afatin, 6 ditë, 7 ditë dhe 7 ditë, me një tejkalim i papërfillshëm, perkatsisht prej 1 dhe 2 ditësh duke patur parasysh vetë ngarkesën e gjyqtarës, ndërkohë që neni 260 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 5 ditë.
- Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 13,14, 15, 18-19, 26, 35-44, me objekt “Dërgim çështje në gjyq janë gjykuar përkatësisht në afatin 64 ditë, 63 ditë, 62 ditë, 52 ditë, 51 ditë, 50 ditë, 45 ditë, 37 ditë, 37 ditë, 37 ditë, 35 ditë, 35 ditë, 34 ditë, 33 ditë, 33 ditë, 32 ditë dhe 31 ditë, ndërkohë që neni 332 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë. Për të gjitha çështjet e mësipërme duke përjashtuar muajin gusht leje vjetore prej 35 ditësh si dhe çështjet për të cilat tejkalimi i afatit është i papërfillshëm prej 1 deri 7 ditë, atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjore.
- Në tabelën nr. 12,⁸⁴ çështja me nr. rendor 5, me objekt “Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal”, është gjykuar në afatin 65 ditë, ndërkohë që neni 291 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë. Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit të kësaj çështje zbresim muajin gusht leje vjetore rej 35 ditësh atehere kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

⁸¹Çështjet me numër rendor 28, 43, 50 dhe 74 nuk janë përfshirë si çështje me afat ligjor, pasi afati ligjor 48 orë për shqyrtimin e kërkesave për përjashtim gjyqtari është parashikuar për herë të parë me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr.35/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.08.2017 dhe këto kërkesa janë regjistruara para kësaj date.

⁸²Këto çështje janë pasqyruar nga gjykata gabimisht në tabelën nr.3 pasi janë kërkesa civile pa palë kundërshtare dhe si të tilla duheshin pasqyruar në tabelën nr.2

⁸³Çështja me numër rendor 10 me objekt “Vleftësim dhe caktim mase”, rezulton të jetë regjistruar në gjykatë në datën 22.12.2018 dhe ka përfunduar në datën 24.12.2018, pra brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 258 i K.Pr.Penale, por gabimisht në tabelën e të dhënave statistikore është pasqyruar si datë regjistrimi data 21.12.2018 ndërkohë nga verifikimi i kryer në sistemin e gjykatave çështja ka datë regjistrimi datën 22.12.2018 <https://qjykata.gov.al/rrethi-kruj%C3%AB/gjykata-e-rrethit-kruj%C3%AB/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-penale/>

⁸⁴Kjo çështje është pasqyruar nga gjykata gabimisht në tabelën nr.12 pasi është kërkesë e fazës së hetimit paraprak dhe si të tillë duhej pasqyruar në tabelën nr.10

Për vitin 2019

- Në tabelën nr. 10, çështjet me nr. rendor 4 dhe 5, me objekt “*Zëvendësim i masës së sigurimit*”, të cilat janë gjykuar në afatin 6 ditë dhe 6 ditë, me një tejkalim të papërfillshëm prej 1 ditë duke marre parasysh ngarkesën e gjyqtares, ndërkohë që neni 260 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 5 ditë.
- Në tabelën nr. 10, çështjet me nr. rendor 16, 17 dhe 18, me objekt “*Caktim mase*”, janë gjykuar në afatin 3 ditë, 3 ditë dhe 3 ditë, ndërkohë që referuar neneve 244 e vijues të K.Pr.Penale, derivon afatin ligjor i gjykimit 48 orë. Në lidhje me çështjet e mësipërme rezulton se çështja me nr. rendor 16 është rregjistruar me datë 20.09.2019 dhe ka përfunduar me datë 23.09.2019, sipas kalendarit viti 2019 data 21, 22 korrespondojnë dite e shtunë dhe e diele, po i njëjti arsyetim është dhe për çështje me nr. rendor 17, 18 të cilat rezultojnë të rregjistruara me datë 27.12.2019 dhe kanë përfunduar me datë 30.12.2019, dhe data 28, 29 dhjetor 2019 janë e shtune dhe e dielë dhe ky tejkalim i vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit;
- Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 27, 30, 33, 36, 43, 48, 51, 55, 57-68, 70, 72-76, me objekt “*Dërgim çështje në gjyq*”, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 61 ditë, 56 ditë, 55 ditë, 50 ditë, 43 ditë, 42 ditë, 39 ditë, 37 ditë, 36 ditë, 35 ditë, 35 ditë, 35 ditë, 35 ditë, 34 ditë, 34 ditë, 34 ditë, 34 ditë, 34 ditë, 33 ditë, 32 ditë, 31 ditë, 31 ditë, 31 ditë dhe 31 ditë, ndërkohë që neni 332 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë. Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve të mësipërme zbresim konkretisht muajin gusht 35 dite, leje vjetore, konkretisht për çështjet me nr. rendor 27, 30, 33, 36, 43, 48, 51, dhe ditët e festave të fundvitit se bashku me mbarjtjet e dosjeve 6 ditë, për çështjet me nr. rendor 57, 58, 58, gjithashtu dhe për çështjet e tjera për të cilat rezultojnë tejkalime të papërfillshme prej 1-4 ditë atëherë konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor sipas nenit 332 i K. Pr. Penale.
- Në tabelën nr. 12,⁸⁵ çështjet me nr. rendor 29, 91 dhe 127, me objekt “*Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal*”, janë gjykuar në afatin 65 ditë, 44 ditë dhe 35 ditë, ndërkohë që neni 291 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë. Për çështjen me nr. rendor 29 nëse nga kohëzgjatja e gjykimit zbresim muajin gusht atëherë kjo çështje ka përfunduar për 30 ditë saç është dhe afati ligjor i parashikuar nga ligji për këto çështje. Po i njëjti arsyetim është dhe për çështjen me nr. rendor 91 e cila rezulton të ketë përfunduar për 9 ditë, ndërsa për çështjën me nr. rendor 127 rezulton e rregjistruar në fund të muajit dhjetor datë 26.12.2019 dhe ka përfunduar në fund të muajit janar me date 31.01.2018 dhe nëse zbresim festat e fundvitit dhe ditët e mbartjes së dosjeve gjithsej 6 ditë, atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar për 29 ditë.

Në formularin e Integruar të Vlerësimit⁸⁶, gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se, gjatë ushtrimit të detyrës është përpjekur maksimalisht të respektojë afatet e parashtruar nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve, sipas kategorive, por gjithmonë duke u kujdesuar që kjo të mos cenohet

⁸⁵Këto çështje janë pasqyruar nga gjykata gabimisht në tabelën nr.12 pasi janë kërkesa të fazës së hetimit paraprak dhe si të tilla duheshin pasqyruar në tabelën nr.10

⁸⁶Shpjegimet e detajuara te gjyqtares pasqyrohen ne mënyre te detajuar në raportin analitik fq. 94-103

kontradiktoritetin, mbrojtën efektive, garantimin e hetimit të plotë e të gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, gjyqtarja ka parashtruar duke argumentuar në mënyrë të detajuar shkaqet apo rrethanat që kanë ndikuar në shqyrtimin tej afateve ligjore në disa prej çështjeve të shqyrtuara prej saj.

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “*Respektimi i afateve ligjore*” në shkallë shumë të lartë. Konkretisht, kryetari është shprehur si vijon: “*Gjyqtarja ka treguar aftësitë e saj organizative në drejtim të përfundimit të çështjeve brenda afateve sa me të shkurtra kohore, megjithë ngarkesën tepër të lartë të çështjeve dhe kompleksitetin e tyre. Tejkalimet e afateve kanë pasur të bëjnë me rrethana që nuk lidhen me gjyqtaren.*”.

Sa më sipër, në total nga 820 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre (duke zbritur çështjet e sipërcituara), rezulton që gjyqtarja ka përfunduar jashtë afatit ligjor 90 çështje ose rreth 10.9% të çështjeve që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, përqindje e cila duhet të pikezohet maksimalisht, duke marrë parasysh gjithashtu shpjegimet e vet gjyqtares, që i referohen ngarkesës numrit të madh të çështjeve të shqyrtuara, problematikat në idhje me njoftimet, veprimeve procedurale që janë të domosdoshme për një proces të rregullt gjyqësorë çka e bën të pamundur përfundimin e çështjeve brenda afatit ligjor.

KONKLUZIONI

Analiza e të dhenave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhenave burimore. Për pikëzimin në rastin konkret duke pasur në konsideratë:

- i) ngarkesën e lartë të gjyqtares, numrit të madh të çështjeve të shqyrtuara nga ana e saj.
- ii) mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtares lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iii) numrin e lartë të çështjeve me afat ligjor, 820 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 32.3% të çështjeve të shqyrtuara prej saj në periudhën e vlerësimit;
- iv) tejkalimin e pragut të përqindjes që çon në pikëzim maksimal të këtij treguesi me vetëm 0.9%,

vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet për këtë tregues maksimalisht, konkretisht me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 10.9 %, por ndërkohë gjyqtarja ka përfunduar një numër tepër të lartë çështjesh ku 820 janë çështje me afat ligjor.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Në analizë tërësore të të dhënave statistikore për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 1710 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat 350 jashtë këtij afati. Rrjedhimisht, gjyqtarja subjekt vlerësimi rezulton të ketë gjykuar 20,5% të çështjeve jashtë afatit standard minimal kohor

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 1710 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Familjare pa palë kundërshtare”, “Marredhenie pune”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje”, “Seanca paraprahe-kërkesa për pushimin e procedimit penal” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo me tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo me tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo me tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo me pak se 10 vjet;
- jo me tej se 4 muaj për kundërvajtjet penale;
- jo me tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo me tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se nga 1710 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat 350 jashtë këtij afati. Rrjedhimisht, gjyqtarja subjekt vlerësimi rezulton të ketë gjykuar 20,5% të çështjeve jashtë afatit standard minimal kohor.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit,⁸⁷ pasqyruar edhe në Raportin analitik, e ka vlerësuar treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” **në shkallë shumë të lartë**.

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” **në shkallë shumë të lartë**. Konkretisht, kryetari është shprehur si vijon: “Vlerësim shumë i lartë i punës së gjyqtarës në lidhje me mirë administrimin e procesit gjyqësor dhe afateve të gjykimit”.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 350 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja (muaj gusht i vitit 2017, vitit 2018 dhe viti 2019). Nëse në përllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

Për vitin 2017,

- Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 32, 40, 66, 71, 72, 74, 78, janë gjykuar përkatësisht në afatin, 186 ditë, 210 ditë, 219 ditë, 196 ditë, 203 ditë, 203 ditë, 218

⁸⁷Shpjegimet e detajuara të gjyqtarës pasqyrohen në mënyrë të detajuar në raportin analitik fq. 94-103

ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj. Nëse zbresim nga kjo përlllogaritje muajin lejen vjetore të muajit gusht për gjyqesorin gjithsej 35 ditë atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjorë prej 180 ditësh dhe pse me një tejkalim të papërfillshëm deri në 6 ditë.

- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 3, 8, 9, 11, 15,16,18,19 dhe 174, janë gjykuar përkatësisht në afatin 78 ditë, 96 ditë, 92 ditë, 79 ditë, 75 ditë, 74 ditë, 72 ditë, 64 ditë, 63 ditë dhe 68 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Nëse zbresim nga kjo përlllogaritje muajin lejen vjetore të muajit gusht për gjyqesorin gjithsej 35 ditë atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjorë prej 60 ditësh dhe pse me një tejkalim të papërfillshëm prej 3-4 ditësh.
- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 52 dhe 54, janë gjykuar përkatësisht në afatin 132 ditë, dhe 160 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Nëse zbresim nga kjo përlllogaritje muajin lejen vjetore të muajit gusht për gjyqesorin gjithsej 35 ditë atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjorë prej 120 ditësh ose me një tejkalim të papërfillshëm prej 3-4 ditësh.
- Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 16, 17, 19 janë gjykuar përkatësisht në afatin 133 ditë, 135 ditë, 128 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Nëse zbresim nga kjo përlllogaritje muajin lejen vjetore të muajit gusht për gjyqesorin gjithsej 35 ditë atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjorë prej 120 ditësh.
- Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 4, 8, 12, 16, 17, 69, 71, janë gjykuar përkatësisht në afatin 61 ditë, 97 ditë, 96 ditë, 87 ditë, 84 ditë, 95 ditë, 95 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Nëse marrim parasysh tejkalimin një ditë të papërfillshëm për vetë ngarkesën e gjyqtarës me numër të madh çështjes të shqyrtura si dhe të zbresim nga kjo përlllogaritje lejen vjetore të muajit gusht për gjyqesorin gjithsej 35 ditë atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjorë prej 60 ditësh.

Për vitin 2018,

- Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 10,14,15,16,20,23, 25, 26,27,30, janë gjykuar përkatësisht në afatin 198 ditë, 217 ditë, 182 ditë, 211 ditë, 216 ditë, 194 ditë, 181 ditë, 192 ditë, 192 ditë dhe 212 ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj. Nëse nuk marrim parasysh tejkalimin e papërfillshëm me 1-6 ditë nga afati standart për vetë ngarkesën e gjyqtarës me numër të madh çështjes të shqyrtura si dhe duke zbritur nga kjo përlllogaritje lejen vjetore të muajit gusht për gjyqesorin gjithsej 35 ditë atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjorë prej 180 ditësh, konkretisht për 163 ditë, 182 ditë, 182 ditë, 176 ditë, 181 ditë, 159 ditë, 157 ditë, 157 ditë, 177 ditë
- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 13,15, 16, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, janë gjykuar përkatësisht në afatin 96 ditë, 89 ditë, 88 ditë, 66 ditë, 65 ditë, 64 ditë, 63 ditë, 63 ditë, 62 ditë, 61 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2

datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Per disa nga ceshtjet e mesiperme nese zbresim muajin gusht lejen vjetore prej 35 ditesh si dhe duke mos marrë parasysh tejkalimet me 1-6 ditë nga afati i percaktuar atëherë konsiderohen të përfunduara brenda standarti minimal te parashikuar nga ligji.

- Në tabelën nr. 4, çështjet me nr. rendor 4, gjykuar në afatin 62 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Në këtë rast kemi një tejkalim të paperfillshem prej dy ditësh nga afati standart i gjykimit prej 60 ditësh.
- Në tabelën nr. 8, çështjet me nr. rendor 3 të cilat përfshin çështje me objekt vepra penale që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe janë gjykuar në afatin 292 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 9 muaj (270 ditë). Nëse zbresim nga kjo përlllogaritje lejen vjetore të muajit gusht për gjyqësorin gjithsej 35 ditë atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjore prej 270 ditësh.
- Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 22 dhe 25, janë gjykuar përkatësisht në afatin 155 ditë dhe 133 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Nese zbresim muajin gusht lejen vjetore prej 35 ditesh nga afati i percaktuar atehere konsiderohen të përfunduara brenda standarti minimal të parashikuar nga ligji konkretisht per 120 ditë dhe 98 ditë.
- Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 97, 98, 104, janë gjykuar përkatësisht në afatin 98 ditë, 96 ditë, 64 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Nese zbresim muajin gusht lejen vjetore prej 35 ditësh nga afati i percaktuar atëherë konsiderohen te përfunduara brenda standarti minimal te parashikuar nga ligji konkretisht per 63, dhe 61 ditë me nje tejkalim të paperfillshëm nga 1-4 ditë dhe për çështjen me nr rendor 104, atëherë konsiderohen të përfunduara brenda standartit minimal të parashikuar nga ligji.
- Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 9, 35, 37, 38, 48, 49, 66, 68, 69, 88, 89, 90, 118, 141, 143, 152, 153, 154, 155, 156, 167, 169, dhe 176, janë gjykuar përkatësisht në afatin 69 ditë, 99 ditë, 69 ditë, 65 ditë, 62 ditë, 71 ditë, 66 ditë, 66 ditë, 70 ditë, 62 ditë, 62 ditë, 98 ditë, 66 ditë, 99 ditë, 92 ditë, 77 ditë, 77 ditë, 62 ditë, 66 ditë dhe 65 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Nese nga kohezjatja e shqyrtimit te ketyre ceshtjeve zbresim 6 dite festa te fundvitit periudhe kjo që përkon me procesin e mbajtjeve të dosjeve nga administratat gjyqësore dhe ndërpritet veprimtaria gjyqësore, gjithashtu dhe muajin gusht leje vjetore prej 35 ditesh atëherë çështjet e mesiperme do të kishin përfunduar konkretisht për 63 ditë, 64 ditë, 63, ditë, 33 ditë, 36 ditë, 66 ditë, 66 ditë, 35 ditë, 56 ditë, 63, ditë, 64, ditë, 57 ditë, 32 ditë, 32 ditë, 62 ditë, 66 ditë, 65 ditë, me tejkalime te paperfillshme prej 1deri në 6 ditë nga minimumi i standartit të parashikuar nga ligji prej 60 ditësh.

Për vitin 2019,

- Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 21, 22, janë gjykuar përkatësisht në afatin 192 ditë dhe 185 ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë

14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj. Nëse marrim parasysh 6 dite të festave të fundviti dhe mbartjes së dosjeve nga administrata gjyqësore dhe muajin gusht leje vjetore prej 35 ditësh atëherë këto çështje do kishin përfunduar me një tejkallim prej 6 ditësh për çështjen në numrin rendor 21 dhe për 150 ditë çështja tjetër me nr. rendor 22 duke u konsideruar të përfunduara brenda afatit standard të parashikuar nga ligji.

- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 19, 20, 21, 22, janë gjykuar përkatësisht në afatin 66 ditë, 63 ditë, 63 ditë, 62 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Për këto çështje tejkallimi me 1-6 ditë është i papërfillshëm nga afati standard minimal, prandaj konsiderohen të përfunduara brenda këtij afati.
- Në tabelën nr. 3, çështja me nr. rendor 5, është gjykuar në afatin 123 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Për këtë çështje tejkallimi me 3-ditë është i papërfillshëm nga afati standard minimal, prandaj konsiderohet e përfunduar brenda këtij afati.
- Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 7, 10, 23, 31, 32, 36 dhe 37, janë gjykuar përkatësisht në afatin 132 ditë, 121 ditë, 132 ditë, 145 ditë, 141 ditë, 150 ditë dhe 137 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Nëse zbresim muajin gusht lejen vjetore prej 35 ditësh nga kohëzgjatja e shqyrtimit të tyre dhe 6 ditë festa e fundviti dhe mbartjet e dosjeve, atëherë konsiderohen të përfunduara brenda standarti minimal të parashikuar nga ligji konkretisht për 126 ditë, 121 ditë, 97 ditë, 127 ditë, 110 ditë, 106 ditë, 115 ditë, 102 ditë dhe me ndonjë tejkallim të papërfillshëm nga 1-7 ditë referuar ngarkesës së madhe të çështjeve që ka shqyrtuar gjyqtarja për këtë vit.
- Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 15, 18, 19, 24, 25, 26, janë gjykuar përkatësisht në afatin 82 ditë, 78 ditë, 76 ditë, 71 ditë, 71 ditë dhe 64 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Nëse zbresim muajin gusht leje vjetore prej 35 ditësh atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduara secila për 47 ditë, 43 ditë, 41 ditë, 36 ditë, 36 ditë, 64 ditë, pra konsiderohen të përfunduar brenda standarti minimal të parashikuar nga ligji dhe pse me ndonjë tejkallim të papërfillshëm prej 4 ditësh.
- Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 1, 22, 24, 28, 30-40, janë gjykuar përkatësisht në afatin 61 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 1 dite*), 76 ditë, 75 ditë, 67 ditë, 64 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 4 dite*), 64 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 4 dite*), 64 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 4 dite*), 63 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 3 dite*), 63 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 3 dite*), 63 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 3 dite*), 63 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 3 dite*), 62 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 2 dite*), 61 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 1 dite*), 61 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 1 dite*) dhe 61 ditë (*tejkallim i papërfillshëm prej 1 ditë*). Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Duke marrë parasysh tejkallime të papërfillshme prej 1-4 dite dhe 35 ditë muaji gusht leja vjetore e gjyqësorit dhe 6 ditë festa e fundviti dhe mbartjet e dosjeve atëherë këto

çështje konsiderohen të përfunduara brenda standartit minimal të parashikuar nga ligji prej 60 ditësh.

Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standartit minimal kohor, do të përjashtoheshin 113 çështjet e analizuara me sipër, të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejës vjetorë, rezultojnë të përfunduara brenda afatit apo ky afat rezulton i tejkaluar me vetëm 1 deri në 7 ditë. Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se nga 1710 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 237 prej tyre ose rreth **13.8% janë gjykuar jashtë standartit** minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 4 pikë.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) Raportit të çështjeve të gjykuara të afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 13.8%;
- b) mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve (*kryesisht kompleksiteti i çështjeve të kategorisë civile të përgjithshme për të cilat kërkohet kryerja e veprimeve procedurale të cilat e bëjnë të pamundur përfundimin e çështjes brendat afatit standart te parashikuar*);
- c) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit 2017-2019, ku rezulton se gjyqtarja ka përfunduar 2530 çështje, nga të cilat 957 çështje me palë kundërshtarë;⁸⁸ ndërkohë që ka qënë e deleguar në tre gjykata, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat,
- d) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore;
- e) ngarkesën e lartë të gjyqtarës,

pavarësisht përqindjes së mësipërmë, vlerësoj se për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel me të lartë pikëzimi, me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa me sipër, aftësia e gjyqtarës për treguesin “Plotësimi i standardëve minimalë kohore” pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatarë që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total: 262 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtarë*”, 567 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë*”, 99 çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtarë*”, 26

⁸⁸Në pikën 3 shkronja “h” të “Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore”, miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me Standardi sasior i punës parashikohet: **h. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtarë.**

çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, 0 çështje të kategorisë “*trëgtare me palë kundërshtare*” 0 çështje të kategorisë “*trëgtare pa palë kundërshtare*”, 0 çështje të kategorisë “*marredhenië punë*”, 86 çështje të kategorisë “*Penale krime*”, 99 çështje të kategorisë “*Penale kundërvajtje*”, 9 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, 58 çështje të kategorisë “*seancë paraprakë*”, si dhe 504 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marredhenieve juridiksionale me jashtë*”.

Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilen kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është me e shkurtër së standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e katëgoritë e çështjeve. Konkrëtisht:

- i. çështjet e kategorisë “*civilë të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 170 ditë, pra me e shkurtër së standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- ii. çështjet e kategorisë “*civilë të përgjithshmë pa palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 25 ditë, pra me e shkurtër së standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- iii. çështjet e kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 74 ditë, pra me e shkurtër së standardi minimal kohor i miratuar prej katër muajsh.
- iv. çështjet e kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 62 ditë, pra më e gjatë së standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh me një tëjkalim të papërfillshëm prej 2 ditësh çka e bën të konsiderohet me e shkurtër së standardi minimal kohor .
- v. çështjet e kategorisë “*Penale krime*”, koha mesatare rezulton të jetë 112 ditë, pra më e shkurtër së standardi minimal kohor i miratuar prej nëntë dhe dymbëdhjetë muajsh.
- vi. çështjet e kategorisë “*Penale kundërvajtje*”, koha mesatare rezulton të jetë 107 ditë, pra me e shkurtër së standardi minimal kohor i miratuar prej katër muajsh.
- vii. çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, koha mesatare rezulton të jetë 9 ditë, pra me e shkurtër së standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- viii. çështjet e kategorisë “*seancë paraprakë*”, koha mesatare rezulton të jetë 75 ditë, pra më e gjatë së standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- ix. çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marredhenieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton të jetë 47 ditë, pra me e shkurtër së standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.

Gjyqtarja subjekt vlerësimi e ka vlerësuar treguesin “*Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje*” **në shkallë shumë të lartë** (nga pesë nivelët: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “*Në vetvlerësimin*

në lidhje me këtë çështje dëshiroj të sjell në vëmendje faktin që kam gjykuar njëherazi çështje Penale dhe civile, vështiresinë realizimin e një njoftimi efektiv për palët ndërgjyqëse në kushtet kur ky komunikim kryhet përmes shërbimit postar, kërkesat e ndryshme për shtyrje seancë me shkaqe të justifikuar që kanë paraqitur palët ndërgjyqësë, apo aktorë të tjerë të procesit si ekspertët, deshmitarët etj, vonesën në kthimin e përgjigjeve nga institucionet në ato rastë kur i kam kërkuar administrimin e dokumentave etj, faktin së përgjatë vitit 2018 gjykata mbeti me 3 gjyqtarë, faktin që përgjatë periudhes së vlerësimit pas largimit të gjyqtarës NP kemi qenë vetëm dy gjyqtarë që kemi mbuluar grafikun vjetor të gadishmërisë, delegimet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Mat dhe Tiranë etj. Nga ana tjetër në vëmendjen tuaj edhe ndryshimet që pësuan Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale në vitin 2017 duke parashikuar afate të shkurtra kohore, në këtë rast duhet të kihet parasysh edhe koha e nevojshme për implementimin dhe njohjen me to nga ana e subjekteve të procesit. Përgjatë vitit 2017 kam gjykuar mbi 650 dosje (në tabelë për këtë vit nuk janë shënuar dosjet gjyqësore me objekt lejim votimi për zgjedhjet e përgjithshme nga IEVP Fushë Krujë dhe IEVP Krujë), në vitin 2018 kam gjykuar 850 dosje, në vitin 2019 kam gjykuar mbi 1000 dosje (në tabelë për këtë vit nuk janë shënuar dosjet gjyqësore me objekt lejim votimi për zgjedhjes lokale nga IEVP Fushë Krujë dhe IEVP Krujë). Në konsideratë për sa me lart, në raport me vlerësoj se kam arritur respektoj një afat gjykimi të lartë për secilen kategori të çështjeve të shqyrtuara.

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” në shkallë **shumë të lartë** duke u shprehur si vijon: “Pasur parasysh rrëthanat konkretë dhe ngarkesën e gjykatës, mëndoj së gjyqtarja është munduar të administrojë në mënyrën me të mirë kohen gjyqësorë.”

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar të dhenave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimëve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton së koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm me e shkurtër së ky afat për 7 nga 9 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është me e gjatë së standardi vetëm për 2 nga 9 kategoritë e çështjeve konkrëtisht për çështjet e kategorisë “familjare pa palë kundërshtare”, ku koha mesatarë rezulton të jetë 62 ditë, me një tejkallim të papërfillshëm prej 2 ditësh çka e bën të konsiderohet me e shkurtër së standardi minimal kohor i parashikuar nga ligji dhe çështjet e kategorisë “seancë paraprakë”, në të cilën koha mesatare rezulton të jetë 75 ditë, pra me e gjatë së standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh, duke u tejkalluar ky afat respektivisht me 15 ditë. Bazuar argumentet e gjyqtarës si më sipër si dhe duke vlerësuar kategorinë e çështjeve për të cilat ky standard rezulton i tejkalluar, ku ndjeshëm kanë ndikuar dhe njoftimet e palëve me anë të shërbimit postar si dhe ndryshimet ligjor, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja, bazuar në analizën logjike të të dhenavë statistikore, duhet të pikëzohet me një nivel me të lartë së ai që rezulton nga analiza matëmatikorë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa me sipër, koha mesatare që i dëdikohët çdo çështjeje duhet të konsiderohët me e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha katëgoritë e çështjeve, pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhen e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (2530 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (2823 çështje) brënda vitit kalendarik, është **89.6%**, përqindje e cila pikëzohet me 6 pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësorë” në shkallë “**Mbi mesataren (Mbi 93-99%)**” (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vëtvlerësim është argumentuar si vijon: “Duke mos rënë në përsëritje të asaj çka ëvidëntova me lart (nënçështja 2.A.c) lidhur me ngarkësën në punë dhe llojshmërinë e çështjeve të gjykuara vlerësoj së kam arritur një nivel të lartë edhe sa i takon rendimentit të përfundimit të çështjeve. Kjo sepse në raport me numrin e dosjeve të caktuara me short, dosjet gjyqësorë të mbartura për secilin vit kalendarik ka qënë rëlativisht i ulët, nga 60 dëri në jo me shumë se 100 dosje.”

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “Rendimëti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Konkrëtisht, Kryetari është shprëhur si vijon: “Gjyqtarja ka përballuar një ngarkesë të konsiderueshme në raport me numrin e çështjeve të ngarkuara.”.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: “Të gjitha të dhenat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhenavë statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtët e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim me të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brënda të njëjtit vit kalendarik me shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”. Sipas pikës 3 shkronja “g”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo me pak së 200 gjykime çështjesh penale themeli dhe çështjes civile me palë kundërshtare. Ndërkohë rezulton së gjyqtarja, në tre vite periudhes së vlerësimit ka përfunduar:

- për vitin 2017 ka përfunduar 219 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar me 19 çështje me shumë së standardin sasior;
- për vitin 2018 ka përfunduar 350 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar me 150 çështje ose 75% standardin sasior;

- për vitin 2019 ka përfunduar 388 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar me 188 çështje ose 94% standardin sasior;

Në total për të gjithë periudhen e vlerësimit, gjyqtarja ka përfunduar **957 çështje me palë kundërshtare**, duke tejkaluar me 357 çështje ose me rreth 59% standardin sasior në fuqi dhe me një rëndiment prej 159%.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimevë të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhen e vlerësimit rezulton në masën 89.6%, por ndërkohë rezulton se ajo ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 59.5%, si dhe ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh pa palë kundërshtare (1578 çështje). Në analizë logjike të të dhënave statistikore dhe shkaqeve që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarës, ato janë të tilla që lidhen me ngarkesën e punës gjatë periudhës së vlerësimit, ngarkesë e cila nga ana tjetër nuk e ka penguar gjyqtarën të tejkalojë standardin sasior në fuqi, tëjkalim ky që rezulton mbi 50% të standardit sasior konkretisht 59.5% duke vlerësuar gjyqtarën maksimalisht për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa me sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet maksimalisht duke u pikëzuar me 10 pikë, pasi sipas pikës 3 shkronja “g”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior gjyqtarja ka tejkaluar standartin sasior me një rëndiment të përfundimit të çështjeve prej 159%.*

2.A.d Koha mesatare e arsyëtimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet së koha mesatare e arsyëtimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si me poshtë:

- ✓ çështje të kategorisë “civilë të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyëtimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 4 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civilë.
- ✓ çështje të kategorisë “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyëtimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 1 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civilë.
- ✓ çështje të kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyëtimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 3 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civilë.
- ✓ çështje të kategorisë “familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyëtimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 6 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civilë.
- ✓ Për çështje të kategorisë “Penale krimë”, koha mesatare e arsyëtimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 6 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

- ✓ çështje të kategorisë “*Penale kundërvajtje*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 6 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hëtimit paraprak*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- i. Për kërkesa me objekt vlëftësim arrësti/ndalimi dhe caktim masë sigurimi, 1 ditë, pra **më i shkurtër** së afati procedural i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale.
- ii. Për kërkesa me objekt caktim masë sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është **1 ditë**, pra **më e gjatë** së afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K.Pr.Penale, i cili kërkon që vendimi të jepët i arsyetuar.
- iii. Për kërkesa me objekt vërifikim i kushtëvë të zbatimit të masës së sigurimit, 1 ditë, pra **më i shkurtër** së afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248 i K.Pr.Penale.
- iv. Për kërkesa me objekt zëvendësim/rëvokim masë sigurimi, 1 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K.Pr.Penale.
- v. Për kërkesa me objekt shuarjë masë sigurimi, 1 ditë, pra **më i shkurtër** së afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K.Pr.Penal.
- vi. Për kërkesa me objekt lëjtim përgjimi/zgjatjë afat përgjimi, 0 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K.Pr.Penale.
- vii. Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 1 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 5 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K.Pr.Penale.
- (i) Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 4 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhëniëve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- i. Për kërkesa me objekt përjashtimin e gjyqtarit (*pas hyrjës në fuqi të ndryshimëvë të K.Pr.Penale me ligjin nr. 35/2017*), koha mesatare e arsyetimit është 0 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 22 i K.Pr.Penale.
- ii. Për kërkesa me objekt rivëndosjë në afat ankimi (*pas hyrjës në fuqi të ndryshimëvë të K.Pr.Penale me ligjin nr. 35/2017*), koha mesatare e arsyetimit është 2 ditë, pra **më e shkurtër** së afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 4201 i K.Pr.Penale.
- iii. Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 5 ditë, **pra më e shkurtër** së afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

Në Formularin e Intërguar të Vlerësimit gjyqtarja dhe zëvendëskryetari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja ka argumentuar si vijon: *“Në rend të parë me lejoni të theksoj faktin së përgjatë gjithë punës si gjyqtare jam kujdesur maksimalisht për të dorëzuar brenda afatëve ligjore të gjitha vendimet gjyqësore. Paraprakisht sqaroj mënyrën e organizimit të punës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe logjistikën që ofron kjo gjykatë sepse është me tepër rëndësi për të evidentuar punën e secilit gjyqtar. me konkrëtisht, në nisje të punës për çdo vit kalendarik kryhej ndryshimi i sekretareve gjyqësore të atashuar pranë çdo gjyqtari. Të gjithë sekretaret gjyqësore kanë punuar në një zyrë të përbashkët në katin e dytë të gjykatës dhe nuk kanë qenë të atashuar pranë zyrës së gjyqtarit. Për këto arsye, që në nisje të punës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë kam mbajtur një bllok shenimesh ku kam evidentuar për të gjitha çështjet datën e dorëzimit të vendimit të arsyetuar pranë sekretarisë gjyqësore. Dorëzimi është kryer në çdo rast përkundrejt nënshkrimit të sekretarit gjyqësor përkatës. Gjithashtu, nisur nga puna voluminoze që kam përballuar përgjatë çdo viti dhe gjykimit të njëkohshëm të çështjeve Penale dhe atyre civile (duke qënë së gjykata nuk ka qënë e ndarë në seksionë) kam hapur praktikën prane kësaj gjykatë duke vëndosur datën e arsytimit të vendimit dhe dorëzimit të dosjes pranë sekretarit gjyqësor edhe në kapakun e dosjës gjyqësore, në kolonën e lidhur me seancat e zhvilluara. Në çdo rast si kohë të arsytimit të vendimit gjyqësor i referohem afateve të caktuara në ligjin e posaçëm. Në rastin e çështjeve të ngutshmë si psh padi të lidhura me urdhëra të mënjëhërshme mbrojtje vendimet janë arsyetuar dhe dorëzuar ditën e vendimmarrjes, çka faktohet edhe me aktet e komunikimit të vendimit institucionëvë përkatësë si Njësia Administrativë apo Bashkia, Komisariatit i Policisë etj. Në rastin e çështjeve civile të lidhura me kërkespadi afati për arsytim të të cilavë është caktuar 20 ditë, sipas ndryshimëvë të KPC në vitin 2017, këto afate janë respektuar me rigorozitet, madje janë dorëzuar në një kohë edhe me të shkurtër. Në rastin e vëndimëvë Penale të lidhura me kërkesa të ngutshme për të cilat ligji parashikon shqyrtim në dhomë këshillimi vendimi është arsyetuar në të njëjten ditë me marrjën e vendimit, përmend rastet e kërkesavë për masa sigurimi në mungesë, lejim apo vlëftësim përgjimi etj. Në çdo rast nuk rezulton që në asnjë rast të jetë raportuar pranë KLGJ për dorëzim me vonesë të vendimeve gjyqësore. ”*

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhenavë statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim me të lartë nga ai i tabelës së mësipërmë, duke zbatuar një koeficient jo me shumë se 20%.

Nga analiza e integruar e të dhenavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se:

- Për kërkesa me objekt **caktim masë sigurimi**, koha mesatare e arsytimit është **1 ditë, pra më e gjatë** së afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K.Pr.Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsytuar. Lidhur me mënyrën e administrimit dhe dorëzimit të dosjeve lidhur me kërkesat me karakter sekret dhe (ii) parashikimevë të ligjit procedural penal, i cili në nenin 244/1⁸⁹ të Kodit të Procedurës Penale parashikon disponimin e gjykatës me vendim të arsytuar, prandaj kjo e dhënë nuk mund të vlerësohet si e saktë. Kjo pasi koha e dorëzimit të

⁸⁹Në nenin 244, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsytet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsytuar”

dosjës gjyqësorë, pas kalimit të afatit për ruajtjen e sekretit hetimor, nuk përputhet me kohen e arsytimit të vendimit, e cila në kuptim të dispozitës ligjor të mësipërme, vlerësohet së bashku me shpjegimet e gjyqtarës, vlerësohet se ka qenë e barabartë me afatin ligjor të arsytimit, aq më tepër që në rastin konkret ky tejkallim është krejtësisht i papërfillshëm.

KONKLZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*”, pasi vërtet për 1 nënkategori çështjesh rezulton që afati procedural të jetë tejkaluar me 1 ditë duke e bërë atë të papërfillshëm për tu marrë në konsideratë, ndërkohë që për të gjitha kategoritë e tjera afati i arsytimit rezulton me i shkurtër së afati procedural. Por ky tejkallim afati vetëm për një nënkategori çështjesh si dhe kohëzgjatja e këtij tejkallimit, sipas Metodologjisë justifikojnë në rastin konkret zbatimin e një niveli me të lartë pikëzimi bazuar në koeficientin 20%, me pasojë pikëzimin me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa me sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangin e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet së numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh,⁹⁰ duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si me poshtë:

- (i) për kategorinë “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” është 7 seanca;⁹¹
- (ii) për kategorinë “*Familjare me palë kundërshtare*” është 1 seancë;⁹²
- (iii) për kategorinë “*Penale themëli*” është 3 seanca;⁹³
- (iv) për kategorinë “*Penale seancë paraprakë*” është 2.8 seanca.⁹⁴

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet së numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton të jetë **4.2 seanca gjyqësore**.⁹⁵

⁹⁰Referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, rezulton se nuk është gjeneruar numri i seancave gjyqësore për të gjitha çështjet. Për pasojë, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, numri mesatar i seancave gjyqësore do të përlogaritet duke iu referuar 19 (nëntëmbëdhjetë) çështjeve me palë kundërshtare, të përzgjedhura me short për vlerësim

⁹¹ 49 seanca : 7= 7seanca

⁹² 2 seanca : 2= 1 seancë

⁹³ 12 seanca : 4= 3 seanca

⁹⁴ 17 seanca : 6= 2.8 seanca

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet së gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonësë të njoftimeve , njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungësa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga Aktet në dosjët burim vlerësimi së gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdher kalim në seancë gjyqësore, pas ezaurimit të veprimeve përgatitore në çështjet civile dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore në çështjet Penale, vendim për caktimin e seancës paraprake*), duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdherimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqësë, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civilë dhe K.Pr.Penale. Ajo çfarë konstatohet është së numrin me të madh të seancave gjyqësore e kanë pikërisht katëgoria e çështjeve civile të themelit për shkak të kompleksitetit të tyre. Nëse nga totali i çështjeve të analizuara do të zbrisnim seanca joproduktive për shkakë të pavarura nga gjyqtarja atëherë mesatarja e seancave gjyqësore për 19 çështjet do të rezultonte në 2.5 seanca.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkakë të ndryshmë proceduralë të tilla si : *me qëllim marrjen e informacionit në lidhje me vëndbanimin e fundit të të paditurit, për rëalizimin e njoftimit për palën e paditur; kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, për përgatitjen e konkluzionëve përfundimtarë me shkrim nga palët, për realizimin e njoftimit për viktimën në procesin penal, për të siguruar pjesëmarrjen e prokurorit në seancë, me qëllim plotësimin e hetimeve paraprake, për shkak të mungësës së gjyqtarës për arsye shëndetësore në dy rastë, për lënien kohë ekspërtiti për të përgatitur aktin e ekspertimit, për marrjen e provave shkresore tek të tretët etj.* Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONI

Bazuar në sa parashtrohet me sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*”, duke iu referuar të dhenave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton 4.2, gjyqtarja në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave. Duke zbritur numrin e seancave joproduktive për shkaqe të pavarura nga gjyqtarja, numri mesatar i seancave gjyqësore do të rezultonte 2.5.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mësatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seances përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorivë të çështjeve. Konkretisht, në çështjet civile gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose pajtimi në çështjet familjare (*neni 158/b i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjës*) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/ç i K.Pr.Civile*). Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtarja ka vënë dosjen në lëvizje brenda ditës ose brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjor, duke caktuar seancën, si dhe ka treguar kujdes për marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton së të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qënë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nënët 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), ose sipas ritit të gjykimeve të seancavë paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale*).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqët e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhenien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancavë gjyqësore, duke pasqyruar shkaku në çdo rast, si dhe urdherimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuesë (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionët e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo

rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimevë të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, përgjithsisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa deri në 15 minuta (të papërfillshme), dhe vetëm një numër i kufizuar seancash rezulton të kenë filluar me vonesa me tëpër së 15 minuta, të cilat lidhen me organizimin dhe përgatitjen e sallës për gjykim ose të diktuar nga kohëzgjatja e seancës pararendese.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.⁹⁶

Ajo çfarë rezulton nga dosjet e vëzhguara burim vlerësimi është se për 3⁹⁷ (tre) nga 6 (gjashtë) çështjet Penale me objekt “Dërgimin në gjyq”, nuk rezulton që i pandehuri të ketë zgjedhur vetë mbrojtës apo t’i jetë caktuar mbrojtës kryesisht nga gjykata si një detyrim i përcaktuar në nenin 332 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se : «*Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake cakton datën e zhvillimit të saj. Në rastet kur i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës, zbatohen rregullat e nenit 49 të këtij Kodi*” dhe neni 332/b, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, parashikon së: “*Seanca zhvillohet me dyer të mbyllura, me pjesëmarrjen e domosdoshmë të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit*”. (Ligji procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes ,konkretisht ligji me nr. 35/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2017).

Në lidhje me këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet duke parashtruar përveçse saktësimin në lidhje me një gabim material tashmë i reflektuar në raport, në menyre të permblodhur si më poshtë se: *...Në projekt-raport, në treguesin e vlerësimit 2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, faqe 45, paragrafi i dytë është konkluduar në vlerësimin me 16 (gjashtëmbëdhjetë) pikë, duke u ulur pikëzimi me 4 (katër) pikë me argumentin se, "Ajo çfarë rezulton nga dosjet e vëzhguara burim vlerësimi është se për 3 (tre) nga 6 (gjashtë) çështjet penale me objekt "Dërgim në gjyq" nuk rezulton që i pandehuri të ketë zgjedhur vetë mbrojtës apo t'i jetë caktuar mbrojtës kryesisht nga gjykata si një detyrim i përcaktuar në nenin 332 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon: "1. Brenda pesë ditëve nga depozitimi i*

⁹⁶Përveç çështjeve të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi për të cilat nuk është mbajtur procesverbal për shkak të rritit të shqyrtimit

⁹⁷ 1- Në çështjen nr. 567 Regj. datë regjistrimi 30.07.2019, nr. Vendimi s'ka, datë vendimi 10.09.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, (me objekt: Dërgim për gjykim i procedimit penal nr.260, viti 2019); 2- Në çështjen nr. 268 Regj. datë regjistrimi 05.10.2017, me nr. Vendimi s'ka, datë vendimi 26.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, (me objekt: Dërgim për gjykim i procedimit penal nr.455, viti 2017), 3- Në çështjen nr. 493 Regj. datë regjistrimi 01.07.2019, nr. s'ka vendimi, datë 16.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë (me objekt: Dërgim për gjykim i procedimit penal nr.360, viti 2018).

kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprahe cakton datën e zhvillimit të saj. Në rastet kur i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës, zbatohen rregullat e nenit 49 të këtij Kodi." dhe "neni 332/b, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se: "1. Seanca zhvillohet me dyer të mbyllura, me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit." (Ligji procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, konkretisht ligji me nr. 35/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2017)." Mendoj se perkete tregues, vlerësimi duhet te ishte "shumë e lartë" me 20 pikë bazuar ne keto argumente: Së pari, në vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", për treguesin "b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor (20 pikë)" parashikohet se, pikëzimi i këtij treguesi bazohet në elementë të tillë si: vënia në lëvizje e dosjes në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore; kryerja e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh caktimin e afateve për të metat e padisë, njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes; planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive; dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale; drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatin mes palëve, duke u shprehur qartë, me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të tyre; fillimi i seancave pa vonesë; regjistrimi audio i seancave; orientimi i palëve për ndjekjen e rrugës alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sikundër është ndërmjetësimi, si dhe në kërkesa të tjera të kësaj natyre dhe kategorie.Pra, elementi i përmendur në projekt-raport mbi faktin e mos caktimit të mbrojtësit kryesisht, në kushtet kur vetë i pandehuri ka zgjedhur të mbrohet vetë nuk përfshihet në kategorinë e treguesit "b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.". Nga ana tjetër, në të gjitha dosjet gjyqësore objekt vlerësimi mendoj se kam respektuar me rigorozitet të gjitha elementët që kërkon vendimi nr. 264, datë 21.11.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, lidhur me treguesin në fjalë. Së dyti, sjell në vëmendjen tuaj se periudha e vlerësimit 2017-2019 përkon me situatën faktike të miratimit të një pjese të paketës së reformës në drejtësi, konkretisht me miratimin gjatë vitit 2017 të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Kodin Penal. Të dyja ligjet procedurale që normojnë procesin gjyqësor civil dhe penal pësuajnë ndryshime thelbësore, duke sjellë risi dhe mbi të gjitha duke ndryshuar në thelb të gjithë procedurën gjyqësore që ndiqej deri në ato momente. Kujtoj se ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile përfshinë komunikimin e deklaratës së mbrojtjes palës së paditur; detyrimin e palëve ndërgjyqëse për të respektuar afatet e caktuara nga gjykata në drejtim të parashtrimit të kërtimeve, pretendimeve, prapësimeve, ndryshimit të objektit të padisë, paraqitjes së kundrapadisë etj., detyrimin ligjor të gjykatës për të kryer veprime paraprahe sipas nenit 158/a Kodi Procedurës Civile, të ndryshuar; kufizimit të rasteve për caktimin e seancës përgatitore etj. Nga ana tjetër, ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale përfshinë gjithashtu ndryshime thelbësore në drejtim të krijimit së një figure të re në procesin gjyqësor penal siç ishte ajo e gjyqtarit të seancës paraprahe; kufizimit të llojit të vendimmarrjes së prokurorit mbi procedimin penal; shtimit të normave të reja mbi urdhërin penal apo gjykimin me marrëveshje; ndryshimi i dispozitave mbi mënyrën e njoftimit të të pandehurit gjatë gjykimit në themel të procedimit penal ndaj tij; përfshirjes së një figure tjetër siç është ajo e viktimës etj. Në periudhën

objekt vlerësimi, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë kam ushtruar edhe funksionin e gjyqtarit për të miturit, sipas ligjit nr. 37/2018 "Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur".

Gjithashtu sjell në vëmendje edhe faktin se në periudhën kohore 2017-2019, që përbën edhe periudhën e vlerësimit, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Gjykata e Lartë ishte pothuaj jo funksionale dhe madje edhe pas vitit 2020 kur nisi të plotësohej me anëtarë të rinj, çështjet e para që mori për shqyrtim ishin dosje të regjistruara pranë saj në vitin 2015 apo edhe më herët. Në këtë kuptim përgjatë periudhës së vlerësimit 2017- 2019 nuk ka patur një praktike njësuere të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë apo të Kolegjit Civil e atij Administrativ mbi mënyrën sesi do të duhej të interpretoheshin të gjitha këto ndryshime ligjore në ligjet procedurale, përfshirë këtu edhe atë se cili është roli i gjyqtarit të seancës paraprake përgjatë fazës së hetimit të procedimit penal, si dhe kufijtë e shtrirjes së të drejtës së mbrojtjes. Se treti, me ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017, në nenin 332/dh, lidhur me vendimmarrjen e gjyqtarit të seancës paraprake parashikohet se, "1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës; b) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit; c) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi;....". Referuar kësaj dispozite, si dhe në tërësi të gjitha normave të tjera të po këtij kodi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e gjyqtarit të seancës paraprake, roli i tij primar ka qenë ai i kontrollit të veprimtarisë së prokurorit dhe hetimit të kryer, në drejtim të saktësisë së akuzës dhe hetimit të plotë e të gjithanshëm të çështjes. Sikundër garantimi i të drejtave të pandehurit, sqarimi dhe bërja me dije i hapave proceduralë dhe të drejtave që ligji i njej atij në fazën e seancës paraprake. Pra, gjyqtari i seancës paraprake, bazuar edhe në nenin 15 të Kodit të Procedurës Penale, përpara ndryshimeve me ligjin nr. 41/2021, në çdo rast nuk mund të vijonte shqyrtimin në themel të çështjes por vendoste për dërgimin e akteve pranë gjyqtarit të themelit. Në vitin 2021, me miratimin e ligjit nr. 41/2021, neni 332/dh u ndryshua si vijon: "1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës; b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit; c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t'u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë. Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit; ç) pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi; d) deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj. ..". Në këtë rast, gjyqtari i seancës paraprake shndërrohet në gjyqtar që shqyrton edhe themelin e çështjes kur palët paraqesin marrëveshje fajësie apo i pandehuri ka kërkesë për gjykim të shkurtuar. Përkundrejt parashikimit ligjor në nenin 332/b të Kodit të Procedurës Penale, mbi faktin pra se seanca paraprake zhvillohet në prani të domosdoshme të mbrojtësit të të pandehurit, në nenin 333 e vijues të po këtij kodi, nuk ka një parashikim të njëjtë nga ligjvënësi, për pasojë, gjatë

shqyrtimit në themel të procedimit penal i pandehuri gëzon të drejtën për t'u mbrojtur vetë. Duke ju rikthyer në mënyrë të veçantë tre dosjeve gjyqësore, të cilat janë bërë shkak për një pikëzim më të ulët sjell në vëmendje se vepra penale për të cilën është regjistruar procedimi penal është "Ndërtimi pa leje" parashikuar nga neni 199/a/1 Kodi Penal, sipas të cilit "Ndërtimi i kryer pa leje, në shkëlqje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. ". Vepra penale parashikon një sanksion që konsiderohet relativisht i ulët dhe i pandehuri nuk ka patur kundërshtime për akuzën ndaj tij, duke qenë i ndërgjegjshëm për veprimin e kryer. Sikundër rezulton nga secila prej këtyre dosjeve gjyqësore, referuar procesverbalit të seancës dhe vendimit përfundimtar jam kujdesur ti bëj me dije të pandehurit të gjitha të drejtat që atij i njeh dhe garanton ligji procedural penal, përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Në këtë aspekt të pandehurit nuk i është cënuar asnjë e drejtë ligjore procedurale, dhe nuk ka ardhur asnjë pasojë në dëm të tij apo në dëm të dhënies së drejtësisë. Faktikisht ka ndodhur që edhe në shqyrtimin në themel të çështjes i pandehuri është mbrojtur vetë dhe gjyqtari i themelit nuk i ka caktuar mbrojtës kryesisht (bashklidhur ju dërgoj vendimet gjyqësore të themelit të shqyrtuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë). Në çdo rast mendoj se mënyra e interpretimit të ligjit procedural penal kontestohet në gjykatën më të lartë sëbashku me vendimin përfundimtar dhe në rastin konkret nuk ka patur pretendime të tilla. Së katërti, në jurisprudencën e saj ndër vite Gjykata Kushtetuese ka theksuar faktin se në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, e drejta e mbrojtjes në procesin penal duhet të jetë efektive dhe jo formale. Për shkak të rolit që kishte gjyqtari i seancës paraprake, në periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional (viti 2017-2019), si dhe kategorizimit të veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/1 Kodi Penal si një vepër e lehtë, e bën mbrojtjen kryesisht jo efektive dhe thjesht forme. Duhet të kemi në vëmendje edhe faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë konsiderohej një gjykatë me organikë dhe buxhet të vogël, për pasojë ishte e pamundur përballimi i të gjitha shpenzimeve në këtë drejtim. Se pesti, mendoj se duhet patur në vëmendje numri i konsiderueshëm i çështjeve që kam përfunduar për secilin vit, më konkretisht mbi 600 çështje në vitin 2017; më tepër se 800 çështje në vitin 2018 dhe më tepër se 1000 çështje në vitin 2019, në tërësi civile dhe penale. ...për treguesin e vlerësimit 2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, pikëzimin me 20 pikë, për pasojë ndryshimin e pikëzimit të përgjithshëm nga 391 në 395 pikë. Në rend të parë bazuar në faktin se elementi i përmendur në projekt-raport mbi faktin e mos caktimit të mbrojtësit kryesisht, në kushtet kur vetë i pandehuri ka zgjedhur të mbrohet vetë nuk përfshihet në kategorinë e treguesit "b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.", sipas vendimit nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e "Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit". Nga ana tjetër për argumentat tjera të përmendura në pikat 2 deri 5 të këtyre kundërshtimeve.

Këshilli, pasi dëgjoi relatorin, e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarës, vlerësoi se nuk ishte rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga relatorja. Gjyqtarja, megjithë kundërshtimet në lidhje me këtë tregues, nuk mund të pikëzohet maksimalisht. Qartazi rezulton të mos jetë respektuar detyrimi i përcaktuar nga neni 332 pika 1 të dhe neni 332/b, i Kodit të Procëdurës Penale, ky veprim procedural nuk është kryer nga ana e gjyqtarës {...} {...}, edhe pse dosjet rezultojnë të

rregjistruara dhe të përfunduara pasi ndryshimet ligjore kishin hyrë në fuqi me date 1 gusht 2017.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhenave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, por lidhur me caktimin kryesisht të mbrojtësit për të pandehurit të cilët nuk kanë zgjedhur një mbrojtës në çështjet penale me objekt “Dërgim për gjyq”, në tre dosjet gjyqësore të vëzhguara rezulton të mos jetë respektuar ky detyrim i përcaktuar nga neni 332 pika 1 të dhe neni 332/b, i Kodit të Procedurës Penale. Në kushtet kur jemi para mosrespektimit për kryerjen e një veprimi konkret procedural në çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes për gjyq”, vlerësoj se në lidhje me këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet me aftësi “mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 16 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 16 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se Aktet e dosjes janë të rënditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjten radhe të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtarja gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të shfrytëzueshmë dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkrësat, procesverbale të seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLZIONI

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet me sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Dokumentacioni është i plotë dhe i saktë duke u përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit dëri në dheniën e vendimit përfundimtar.

Në çdo dosjë administrohen aktet shkresorë të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesëpadia, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, komunikimet shkresorë me të tretët, urdhri/vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësorë, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyëtuara, vendimet gjyqësorë përfundimtare*). Seancat gjyqësore janë regjistruar në audio dhe është mbajtur procesverbal i përmbledhur nga sekretaria gjyqësore⁹⁸

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton së gjyqtarja {...} ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
96	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtëtues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij KRITERI bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e

⁹⁸ Përveç çështjeve të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi për të cilat nuk është mbajtur procesverbal për shkak të rritit të shqyrtimi

pikëvë referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhenavë të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimevë të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren, {...} {...} gjatë periudhes së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhen e vlerësimit vitet 2017-2019, ndaj gjyqtares rezulton të jenë paraqitur 11 (njëmbëdhjetë) ankesa për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 3200/3 prot., datë 22.02.2022, nr. 347/2 prot, datë 31.03.2022, nr.2018/3 prot., datë 26.07.2022, nr. 3460/1 prot., datë 18.11.2021, nr.1458 prot., datë 03.07.2020, nr.1379 prot., datë 29.06.2020, nr.2838/1 prot., datë 23.01.2023 dhe nr. 237 prot, datë 19.01.2023 , nr.2866/1 prot., datë 05.12.2022, nr.2807/1 prot., datë 14.11.2022, nr.2825/1 prot., datë 06.10.2023 ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të derguara nga ILD, rezulton si me poshtë:

Me shkresën me Nr.2269/1 prot., datë 01.06.2021 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar informacionin në lidhje me verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtares {...}. Nga përmbajtja e kësaj shkrese ka rezultuar se pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për gjyqtaren {...} gjatë periudhës 01.01.2017-31.12.2019, rezultojnë të jenë paraqitur 11(njëmbëdhjetë) ankesa, konkretisht:

1. Ankues z. {...}, depozituar ankesa pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2811 prot., datë 26.09.2017 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1285 prot., datë 22.02.2021.
2. Ankues subjekti "Shoqëria përmbarimore {...}, depozituar ankesa pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr. 3287 prot., datë 30.10.2017, dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 347 prot., datë 29.01.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, nga Inspektorati i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë është miratuar vendimi nr. 3287/2 prot., datë 07.05.2018 "Për verifikimin e ankesës së subjektit Shoqëria përmbarimore "AFA 12" sh.p.k, ndaj veprimtarisë së gjyqtares {...}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë".
3. Ankues z. {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 962 prot., datë 12.02.2019 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 858 prot., datë 03.06.2020.
4. Ankues z. {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 562 prot., datë 30.01.2019 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 847 prot., datë 02.06.2020.
5. Ankues z. {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 2827 prot., datë 22.05.2019 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1149 prot., datë 15.06.2020.

6. Ankues z. {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3067 prot., datë 06.06.2019 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1186 prot., datë 17.06.2020.
7. Ankues z. {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 5093 prot., datë 15.10.2019 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1379 prot., datë 29.06.2020.
8. Ankuese znj {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 6099 prot., datë 11.12.2019 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1458 prot., datë 03.07.2020.
9. Ankues z. {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 2346 prot., datë 23.04.2019 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1081 prot., datë 10.06.2020.
10. Ankues z. {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 2558 prot., datë 07.05.2019 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1143 prot., datë 15.06.2020.
11. Ankues z. Ismail Miri, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 445 prot., datë 22.01.2020 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1714 prot., datë 14.07.2020.

Sipas shkresave të dërguara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me ankesat e mësipërmë, rezulton që ato të jenë arkivuar.

Kështu me shkresën nr.1907/2 Prot., datë 05.10.2022 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar informacionin se për gjyqtaren {...} rezultatet që lidhen me trajtimin e ankesave janë si me poshtë:

- Ankues z. {...} ka depozituar pranë ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë ankesën nr. 2811 prot., datë 26.09.2017, përcjellë për kompetencë trajtimi pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, regjistruar me nr. 1285 prot., datë 22.02.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës me vendimin nr. 3200/3 prot., datë 22.02.2022 "*Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. {...} {...}j*", Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivimin e ankesës.

Në këtë vendim është arsyetuar ndër të tjera se: "*Ankuesi ngre pretendime, për mosrespektim formal të ligjit nga ana magjstrates {...}Tahiraj, pasi ka vazhduar gjykimin e proceseve gjyqësore në bazë të nenit 478 të Kodit të Procedurës Penale, megjithëse ky nen sipas tij është shfuqizuar...Pretendimet e ankuesit ndaj magjstrates {...}Tahiraj në thelb janë pretendime të cilat lidhen me mosrespektimin nga ana e magjstrates të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor. Referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor, është kompetencë e gjykatave me të larta, në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit/rekursit të parashikuara në ligjet e sipërcituara... Nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve të paraqitura, konstatohet se nuk evidentohen të dhëna që tregojnë se sjellja apo veprimet e magjstrates {...}{...}, janë të natyrës së tillë që të përbëjnë shkelje disiplinore sipas parashikimeve të bëra nga nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Për rrjedhojë, vlerësohet se ankesa nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë*

referuar nenit 120, pika 1, shkronjat "d" dhe "dh" të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121 pika 2 shkronja "a", të këtij ligji...".

- Ankues subjekti "AFA-2010" shpk ka depozituar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ankesën nr. 3287 prot., datë 30.10.2017, përcjellë për kompetencë trajtimi pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, regjistruar me nr. 347 prot., datë 29.01.2021. Pas verifikimit të ankesës me vendimin nr. 347/2 prot., datë 31.03.2022 "Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga Shoqëria Përmbartimore "AFA-2010" shpk", Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivimin e ankesës.

Në këtë vendim është arsyetuar ndër të tjera se: *"Ankuesi ngre pretendime si, fakti se gjykimi është realizuar tej afatit ligjor prej 20 ditësh të parashikuar në ligj, kanë filluar me vonesë, sjellja e gjyqtarës nuk ka qenë në respekt të normave të etikes, përfaqësuesi i palës nuk legjitimohej pasi nuk ishte i regjistruar në degën e tatim taksave, gjykimi është realizuar njëherë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë...Ish Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë pas shqyrtimit paraprak të ankesës, me vendimin nr. 3287/2 prot., datë 07.05.2018 ka vendosur, për verifikimin e ankesës së subjektit Shoqëria Përmbartimore "AFA-2010" sh. p. k. ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës {...} të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në përmbajtjen të vendimit arsyetohet se, pretendimet e ankuesit për sjellje jo etike nuk janë shoqëruar me prova dhe nuk adreson kërkimin e ndonjë prove, prandaj ky pretendim nuk mund të shqyrtohet, gjithashtu dhe pretendimet lidhur me moslegjitimitimin e palës paditëse për shkak se nuk është i regjistruar në degën e tatim taksave, nuk merren në konsideratë pasi kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe janë pjesë e kontrollit gjyqësor. Ndërsa lidhur me pretendimin për gjykimin tej afatit ligjor dhe fillimin me vonesë të seancave gjyqësore është arritur në përfundimin se duhet të verifikohen, për këtë qëllim me shkresën nr. 3287/3, datë 07.05.2018 është kërkuar informacion shtesë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë. Informacioni dhe të dhënat e kërkuara janë dërguar me shkresën nr. 99 prot., datë 16.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, administruar pranë ish-KLD me nr. 3287/8, datë 21.05.2018...Nga data 07.09.2017 e caktimit të çështjes deri në shpalljen e vendimit data 03.10.2017, rezulton se gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur 26 ditë. Në tejkalimin e afatit të parashikuar në nenin 610, paragrafi i tretë i K. Pr. Civile kanë ndikuar, konstatimi i të metave të padisë dhe lënia e afatit për plotësim si dhe kërkesa për shtyerje e personit të tretë palë në gjykim. Referuar analizës së mësipërme çmohet se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes gjyqësore të ankuesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë është brenda afatit të arsyeshem, duke patur parasysh dhe shkaqet e shtyrjes së seancave, kjo në referencë të afatit të parashikuar në Ankesin 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve referuar vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së, si dhe në nenin 399/2 pika 3, e Kodit të Procedurës Civile. Nga të dhënat e grumbulluara në funksion të verifikimit të ankesës, rezulton se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, për kryerjen e ndonjë shkelje disiplinore në procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjyqtare {...}...Në konkluzion të sa me sipër, arrihet në përfundimin se, në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës {...}, të ushtruar gjatë gjykimit të çështjes të referuar nga ankuesi, nuk identifikohen veprime të qëllimshme për zvarritje të shqyrtimit të kësaj çështjeje dhe për rrjedhojë nuk ka fakte të mjaftueshme që të justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj saj për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e*

gjuqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet, sipas parashikimit në nenin 122, pikat 4 të këtij ligji...".

- Ankues z. Petrit dhe Lumturi Doçi i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesat nr. 858 prot., datë 03.06.2020 dhe nr 847 prot., datë 02.06.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave me vendimin nr. 2018/3 prot., datë 26.07.2022 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të shtetasve Petrit dhe Lumturie Doçi", Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivimin e ankesës.

Ankuesit kanë ngritur pretendime për disa gjyqtarë dhe ankesat janë bashkuar. Për gjyqtaren {...} është ankuar për dhënien e vendimit nr.176, datë 02.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në vendim është arsyetuar ndër të tjera se: *"Pretendimet e ankuesve ndaj veprimtarisë së këtyre gjyqtarëve vlerësohen të jenë pretendime jashtë periudhës së parashkrimit të parashikuar nga neni 34/2 i ligjit nr. 9877 datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe neni 117 i ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar i cili parashikon se: "Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve."....Në lidhje me pretendimet e ankuesit ndaj gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë {...} lidhur me vendimet e dhëna nga kjo gjyqtare, me objekt: Përrjashtim gjyqtari" me nr. 296, datë 26.09.2017; nr. 281, datë 10.07.2019 dhe nr. 34, datë 11.02.2020; nr. 296, datë 25.10.2018 dhe nr. 246, datë 26.11.2018, vlen e njëjta analizë e sipërcituar. Edhe këto pretendime janë të natyrës procedurale dhe që zgjidhen mbi bazë apelimi gjyqësor nga një gjykatë me e lartë. Vendimet për rrëzim kërkesë për përrjashtim të gjyqtarit janë vendime të cilat ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar të gjykatës, kjo referuar parashikimeve të nenit 75, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë ankesat ndaj kësaj magjistrate duhet të arkivohen nisur nga përmbajtja e tyre që nuk janë të natyrës disiplinore, duke mos u plotësuar kushti i pranueshmërisë së ankesës të parashikuar nga neni 120 pika 1 shkronjat: d), dh) të ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin"."*

- Ankues z. Pashk Lleshi ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ankesën nr. 2827 prot., datë 22.05.2019, përcjellë për kompetencë trajtimi pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, regjistruar me nr. 1149 prot., datë 15.06.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës me vendimin nr. 3460/1 prot., datë 18.11.2021 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Pashk Lleshi", Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivimin e ankesave.

Në vendim është arsyetuar ndër të tjera se: *"Ankuesi nuk ka ngritur pretendime konkrete që lidhen me konstatime të veprime ose mosveprimeve, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të cilat mund të jetë kryer një nga shkeljet disiplinore të parashikuara nga nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar...Për rrjedhojë, vlerësohet se ankesa nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë referuar nenit 120, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*

Me shkresën nr.1907/3 Prot., datë 12.10.2022 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar informacionin se për gjyqtaren {...} rezultatet që lidhen me trajtimin e ankesave janë si me poshtë:

1. Ankesa e shtetasës znj. {...} me nr. 6099 prot., datë 11.12.2019, përcjellë për kompetencë trajtimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1458 prot., datë 03.07.2020. Inspektori i Lartë i Drejtësisë pas shqyrtimit fillestar të ankesës, me vendimin nr. 2040/1 prot., datë 07.10.2022 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. {...} ka vendosur arkivimin e ankesës.

Në vendim është arsyetuar ndër të tjera se: *"Pretendimet e ankueses, se në seancën e administrimit të dëshmitëve të dy dëshmitarëve akularë gjyqtarja thujse nuk tregoi as vëmendjen minimale, por të gjithë kohën e seancës është marrë vetëm me telefonin e saj personal, janë në terma të përgjithshëm dhe nuk pasqyrojnë fakte apo indicie të besueshme që të krijojnë dyshimin e arsyeshëm se mund të jetë kryer, nga magjistratja {...}, ndonjë shkelje disiplinore e parashikuar në ligjin 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Edhe pretendimi i ankueses, se kur u krijua bindja se kërkesa ishte bazuar në fakte e prova dhe dëshmitë e dëshmitarëve okular qenë korrekte dhe të sakta, gjyqtaria pa zbatuar as minimumin e transparencës gjyqësore mori vendimin nr.456, datë 21.11.2019, duke bërë rrëzimin e kërkesës, janë pretendime që në thelb lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe vlerësimit të provave nga gjykata respektive. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave është atribut i pushtetit gjyqësor dhe kompetencë ekskluzive e gjykatës. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të marrë atributet e një organi tjetër, sikundërse është gjykata....Natyra e pretendimeve të ankueses ndaj gjyqtarës {...}, nuk rezulton të jenë me natyrë disiplinore, të parashikuara shprehimisht në nenet 102, 103 dhe 104 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Në këto kushte, kjo ankesë nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë referuar nenit 120 pika 1, shkronja "d" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121 pika 2 shkronja "a", të këtij ligji."*

Me shkresën nr.1907/4 Prot., datë 18.10.2022 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar informacionin se për gjyqtarën {...} rezultatet që lidhen me trajtimin e ankesave janë si me poshtë:

1. Ankesa e shtetasit z. {...}, me nr. 5093 prot., datë 15.10.2019, përcjellë për kompetencë trajtimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1379 prot., datë 29.06.2020. Inspektori i Lartë i Drejtësisë pas shqyrtimit fillestar të ankesës me vendimin nr. 1993/3 prot., datë 11.10.2022 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasit z. Shefki Restami", ka vendosur arkivimin e ankesës.

Në vendim është arsyetuar ndër të tjera se: *"Referuar kushteve të pranueshmërisë së ankesës të parashikuara në shkronjat: "d" dhe "dh" të pikës 1, të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nga shqyrtimi fillestar i ankesës, konstatohet se ngrihen pretendime ndaj magjistrates {...} në lidhje me vendimmarrjen me nr. 317 datë 23.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, si vendim i marrë në formë arbitrare dhe me "rrena", si dhe pretendime për shkelje të të drejtave të shtetasit në seancë gjyqësore, për thirrje të gjyqit me dy vjet, për manipulim të padisë me alibi, për fshehje të kërtimeve të tij të padisë që nuk dalin në vendim, për shkelje të procedurës civile dhe vendimeve unifikuese, për veprime të fshehta "tinës" ankuesit si paditës e në favor të palës tjetër për proces gjyqësor fiktiv, pa*

asnjë lloj hetimi gjyqësor pa debat, pa pohime e mohime, pa kontradiktoritet, pa pyetje e përgjigje e deri veprimi me konflikt interesi. Ndërkohë ndaj vendimit nr. 317, i datës 23.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, është ushtruar e drejta e ankimit dhe sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit Tiranë, kjo çështje nga data 08.09.2021 i ka rënë për gjykim gjyqtarës relatores Valdete Hoxha, dhe deri në datën 06.07.2022, nuk është planifikuar për gjykim. Pretendimet e ankuesit ndaj magjistrates {...} janë pretendime, të cilat lidhen me zgjidhjen në themel të çështjes dhe si të tilla ato zgjidhen mbi bazë apelimi gjyqësor vetëm nga gjykata me e lartë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të marrë atributet e gjykatës me të lartë dhe të kontrollojë apo të ndryshojë vendimmarrjen e saj...Nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve të paraqitura konstatohet se nuk ngrihen dyshime të arsyeshme se sjellja apo veprimet e magjistrates {...} janë të natyrës së tillë që të përbëjnë shkelje disiplinore sipas parashikimeve të bëra nga nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Për sa me sipër, vlerësohet se ankesa e ankuesit Shefki Restami nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, kjo referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara, të parashikuar nga neni 120, pika 1 shkronjat: "d" dhe "dh", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për rrjedhojë ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121, pika 2 shkronja "a", të këtij ligji."

Me shkresën nr.333/1 Prot., datë 24.01.2023 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar informacionin se për gjyqtaren {...} rezultatet që lidhen me trajtimin e ankesave janë si me poshtë:

- Ankesa e shtetasit z. {...}, me nr. 3067 prot., datë 06.06.2019, përcjellë për kompetencë trajtimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1186 prot., datë 17.06.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.2838/1 prot., datë 23.01.2023 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Jusuf Rama", ka vendosur arkivimin e ankesës.

Ankuesi ngre pretendime mbi vendimmarrjen e Gjykatës Krujë dhe Prokurorisë Krujë, duke parashtruar se nuk është marrë parasysh gjendja shëndetësore dhe familjare e tij në dhënien e vendimit, si dhe pretendime lidhur me faktin se, nuk kanë marrë parasysh kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar, duke cenuar rëndë të drejtat e tij në proces. Në vendim është arsyetuar ndër të tjera se: "Ankuesi ngre pretendime të cilat i referohen fakteve që kanë ndodhur jashtë afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor, pasi ato i referohen çështjes penale disponuar me vendimin nr. 185, datë 16.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, lënë në fuqi me vendimin nr. 509, datë 05.04.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Për rrjedhojë, ankesa nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë të parashikuar në nenin 120, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."

- Ankesat e shtetasit z. Muharrem Hoqja, me nr. 2346 prot., datë 23.04.2019 dhe nr. 2558 prot., datë 07.05.2019, përcjellë për kompetencë trajtimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1081 prot., datë 10.06.2020 dhe nr. 1143 prot., datë 15.06.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2866/1 prot., datë

05.12.2022 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara, të paraqitura nga shtetasi z. {...} ka vendosur arkivimin e ankesës.

Ankuesi ngre pretendime se gjyqtarja ka arsyetuar vendime në kundërshtim me ligjin. Në vendim është arsyetuar ndër të tjera se: "Pretendimet e ngritura në ankesat e bashkuara ndaj gjyqtarës {...}, plotësojnë kushtin e pranueshmërisë të parashikuar në nenin 120, pika 1, shkronja "ç" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Lidhur me ankesën ndaj sjelljes / veprimtarisë gjyqësore të magjistrates, rezulton se këto janë pretendime në terma të përgjithshëm, të pashoqëruar me argumente dhe prova konkretë dhe nuk pasqyrojnë fakte apo indicje të besueshme të cilat të krijojnë dyshime të arsyeshme se magjistratja ka kryer veprime apo ka shfaqur sjellje që klasifikohen si shkelje disiplinore në kuptim të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Nga dokumentacioni që i bashkëlidhet ankesave të bashkuara, rezulton se ankuesi ka ushtruar ankim ndaj vendimeve nr. 445, datë 08.11.2018 dhe nr. 69, datë 19.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Ndërkohë ankuesi ka shprehur kundërshtinë e tij me "bindjen e brendshme" të gjyqtarës, kundërshti që duhet të jetë pasyruar edhe në ankimet përkatëse të ushtruara nga ankuesi...pretendimet e ankuesit nuk janë të natyrës që përbëjnë shkelje disiplinore sipas përcaktimeve të neneve 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar duke mos u plotësuar kushtet e pranueshmërisë të parashikuar nga neni 120, pika 1, shkronjat "d", dhe "dh", të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Mospërmbushja e këtyre kushteve sjell si pasojë edhe arkivimin e ankesave të bashkuara."

- Ankesa e shtetasit z. {...}, përcjellë për kompetencë trajtimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me nr. 445 prot., datë 22.01.2020, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1714 prot., datë 14.07.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2807/1 prot., datë 14.11.2022 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. {...}ka vendosur arkivimin e ankesës.

Në vendim është arsyetuar ndër të tjera se: "Pretendimet e ngritura nga ankuesi ndaj vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me... nr. 123/711 akti, datë 03.06.2014 dhënë nga gjyqtarja {...}, janë jashtë afatit të parashkrimit të parashikuar nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Për rrjedhojë, ankesat nuk plotësojnë kushtin e pranueshmërisë të parashikuar në nenin 120, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar."

Me shkresën nr.272/1 Prot., datë 20.02.2024 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar informacionin se për gjyqtaren {...} rezultatet që lidhen me trajtimin e ankesave janë si me poshtë:

1. Për gjyqtaren {...} rezultatet që lidhen me trajtimin e ankesave janë si me poshtë: Informacion periodik i ardhur nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 652 prot., datë 05.02.2021. Pas verifikimit të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2825/1 prot., datë 06.10.2023 "Për arkivimin pas verifikimit të informacioneve periodike të ardhura nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë mbi çështjet

e zvarritura mbi dy vjet për muajin tetor 2017 dhe muajin janar 2018", ka vendosur arkivimin e ankesës.

Në vendim është arsyetuar ndër të tjera se: "...Lidhur me veprimtarinë e gjyqtares {...}, në gjykimin e çështjes me nr. 13/29/148/788, me palë: paditës M. P., i paditur Gj. Sh., Komisioni Vendor i Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durrës, me objekt "Pavlefshmëri akti marrje toke", nga dokumentacioni i ardhur nga gjykata rezulton se kjo çështje është regjistruar pranë gjykatës me datë 23.10.2015, dhe me datë 27.10.2015 i ka kaluar manualisht gjyqtares {...} bazuar në vendimin nr. 3 datë 28.04.2015 të Kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së lartë e cila ka vendosur prishjen e vendimit të datës 05.02.2014 për nxjerrjen jashtë kompetencës lëndore, pra me herët kjo çështje ka qenë në shqyrtim nga kjo gjyqtare.... Në ecurinë e gjykimit të kësaj çështje rezulton se në seancën e tretë të planifikuar nga gjyqtarja, të datës 07.12.2015, pas rreth 5 javësh nga marrja në dorëzim e çështjes gjyqësore, pala e paditur Komisioni Vendor i Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durrës ka kërkuar pezullimin e gjykimit duke pretenduar se në Gjykatën Administrative të është duke u zhvilluar një çështje tjetër e cila ka lidhje me atë objekt gjykimi dhe se pa u zgjidhur çështja administrative nuk mund të zgjidhet kjo çështje në gjykim civil.....Në përfundim gjykata ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes civile nr. 788 akti datë 23.10.2015 regj....Në vijim vetëm në seancën e datës 12.07.2018, gjykata bazuar në informacionin e ardhur nga gjykata e apelit shkaku i pezullimit të çështjes ka rënë, ndaj dhe shtyn seancën për të mundësuar paraqitjen e palëve në seancën tjetër, caktuar me datë 26.07.2018, brenda dy javëve. Në seancën e datës 26.07.2018 pas verifikimit të prezencës së palëve, gjykata kalon çështjen në seancë gjyqësore dhe cakton datën 18.09.2018 për të dëgjuar palët. Në seancën e datës 18.09.2018, pala paditëse u shpreh për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështje, dhe të njëjtën gjë kërkoi edhe pala e paditur që kërkoi që ky gjykim të mos vijojë, ndaj dhe gjykata bazuar në nenet 127, 201/1 299/c dhe 300/2 të Kodit të Procedurës Penale vendosi pushimin e gjykimit të çështjes civile nr. ((13/29) / 148) / 788 akti. Nga sa me sipër, rezulton se nga momenti që kjo dosje i ka kaluar gjyqtares me datë 27.10.2015 dhe deri në momentin e dhënies së vendimit të themelit datë 18.09.2018, gjykimi i çështjes ka vajtur për afërsisht 2 vite, 10 muaj e 21 ditë. Në nenin 399/2, pika 3 e K. Pr. Civile i cili parashikon se: "Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.", në total kjo çështje duke mos llogaritur kohën e pezullimit të saj [07.12.2015 12.07.2018] prej 2 vite, 7 muaj e 5 ditë, ka qenë në dispozicion të gjyqtares për një periudhë prej 3 muaj e 16 ditë. Ky afat kohëzgjatje të gjykimit të kësaj çështje nga ana e gjyqtares është brenda afatin standard minimal prej 6 muajsh të parashikuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve", Aneksi 1, pika 5, shkronja "e", si dhe afatin e arsyeshëm 2 vjeçar të parashikuar në nenin 399/2 pika 1, shkronja "b" të K. Pr. Civile. Në rastin konkret vlerësohet se veprimet dhe sjellja e gjyqtares është në përputhje me detyrimet për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe brënda afateve me arsyeshme. Sa me sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtares subjekt vlerësimi."

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtares subjekt vlerësimi.

Gjithashtu referuar kërkeses për informacion mbi vendimet përfundimtare për masa disiplinore të dhëna ndaj gjyqtares {...} rezulton se nga organet kompetente nuk është depozituar asnjë vendim i tillë, për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka sqaruar se nuk disponon informacionin e kërkuar.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtares në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton së gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cënojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton së gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa me sipër, etika e gjyqtares në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtares

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhen 01.01.2017-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD 11 (njëmbëdhjetë) ankesa, të trajtuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili ka vendosur arkivimin pas shqyrtimit fillëstar, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit me sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cënim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhenë apo indicië që të dëshmojë shfaqjen e sjelljëve që trëgojnë mungësë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cënojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...} {...}, gjatë periudhes së vlerësimit të jetë dhenë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar Raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkrësën nr. 2807/1 prot., datë 09.07.2021, rezulton së: “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve

publikë”, i ndryshuar dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet së për gjyqtaren {...} {...}: a) Deklaratat e interesave privatë periodike/vjetorë 2017-2020 janë dorëzuar brënda afateve ligjor; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave privatë janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave”.

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë. I njëjti vlerësim është dhënë edhe nga zëvendëskryetari i gjykatës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të deshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cënim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës, shfaqjen e sjelljeve që trëgojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarës.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhenave që mund të tregojnë për cënim të integritetit të gjyqtarës, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljësive të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarës

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhenave nga vetëvlerësimi i gjyqtarës.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton së gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të

drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektët e procedimit ose në përmbajtjen e vendimëve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton së gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton së për periudhen e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 62 (gjashtëdhjetë e dy) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat 3 (tre) kërkesa janë pranuar. Po kështu, rezulton së edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 243 (dyqind e dyzet e tre) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) janë pranuar.

KONKLUZIONI

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, referuar dhenave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve 3 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PËRSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti përsonal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton së gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyëten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncizë dhe drejtpërdrejtë. Në Aktet shkrësore drëjtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, marrjen e provave nga të tretët, etj.*) është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e sakte dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja dhe Zëvendëskryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton së gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhenave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhenë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhenave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet së gjyqtarja {...} {...} ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Rëspëktimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës lidhur me këtë tregues, vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhenë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar së shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjor.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhenat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton së shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhena negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar së gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhenat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton së shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në vëprimtari të tjëra.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programët e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton së gjyqtarja {...} {...}, gjatë periudhes së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhduës të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses dhe pjesëmarrëses. Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 20 (njëzet) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhen e vlerësimit të konvertuara në 23 (njëzet e tre) ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhen tre vjeçare.

KONKLuzioni

Referuar të dhenavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton së gjyqtarja {...} {...} ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtes civile, administrative dhe penale, gjithsesj 23 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhen tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnimë dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnimë është brenda kufijve 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhehequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarevë.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton së gjyqtarja është angazhuar në programin e formimit vazhduës së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses në 14 (katërbëdhjetë) aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhduës të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në sa parashtrohet me sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kritëri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në vëprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohën në rast vërtëtimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} {...} duke qenë së rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses në 14 (katërbëdhjetë) aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLZIONI

Referuar të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese pranë Shkollës së Magjistraturës.

***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë të dhëna për periudhen e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në formularin e Vetëvlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se ka qënë e anagazhuar në procesin e mësimdhënies si më poshtë vijon:

Tetor 2011-shkurt 2012 dhe tetor 2012-shkurt 2013 Pedagoge e jashtme pranë Universitetit jopublik “Akademia Profesionale e Biznesit” për sistemin full-time pasdite, viti i parë, për lëndën “E drejta civile”, duke mbuluar ciklin e leksioneve dhe atë të seminareve.⁹⁹

Tetor 2016-shkurt 2017 Pedagoge e jashtme pranë Universitetit publik “Aleksandër Moisiu” Fakulteti i Shkencave Juridiko-Politike viti i parë, për lëndën “E drejta Kushtetuese”, duke mbuluar ciklin e leksioneve dhe atë të seminareve. Mars 2017-korrik 2017 Pedagoge e jashtme pranë Universitetit publik “Aleksandër Moisiu” Fakulteti i Shkencave Juridiko-Politike viti i parë, për lëndën “Të drejtat e njeriut”, duke mbuluar ciklin e leksioneve dhe atë të seminareve.¹⁰⁰

Zv/Kryetari i gjykatës, në lidhje me treguesin “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, është shprehur se: “Gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete jashtëgjyqësore sa herë i është kërkuar.”

Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si (listë joshtëruese): fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombetare dhe ndërkombetare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me

⁹⁹ Jashtë periudhës së vlerësimit.

¹⁰⁰ Bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit, gjenden: vërtetim nr.284 Prot., datë 29.07.2020, sipas të cilit znj.{...} {...}, ka ofruar shërbimin e mësimdhënies pranë institucionit arsimor “Kolegji Universitar i Biznesit”, për vitet 2011-2013; vërtetim i universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, sipas të cilit Znj. {...}, ka qënë lektore me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2016-2017;

Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e lëgjislativës; aktivitete mesimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe të interesave të ndryshme me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridikë.

Në të gjitha format e shfaqjes së veprimtarisë ndërinstitucionale, duhet të provohet kontributi dhe angazhimi efektiv i gjyqtarëve për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarëve, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vertetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarët, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarëve, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vertetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarët {...} {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarëve për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarëve në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, për gjatë periudhës 2019-2019 nuk rezultojnë të dhëna.

Gjyqtarja {...} {...} ka depozituar në KLGj, për efekt vlerësimi botimin me titull "Opinionet dhe Rekomandimet rreth projektit për një drejtësi pa vonesa", por është botim i vitit 2014 që nuk i përket periudhës së vlerësimit 2017-2019.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën e vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjor akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhenave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarës, duke e pikëzuar me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
KritEri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizativë të gjyqtarës	96	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Propozim per nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vleresimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhenave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandoj që gjyqtarja {...} {...} të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në fushën e publikimeve ligjor dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhenien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

OJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFËSIONALË TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimët	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhena për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjor	a. Aftësia për të identifikuar natyren e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normavë	1. Dokumentet ligjor të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjor të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyëtimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjor të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë	

		gjqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshmë dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjor të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumëntimit logjik	1. Dokumentet ligjor të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVË TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				96	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimët	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Mëtodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkësën në punë	a. Rëspëktimi i afatëve ligjor	1. Të dhenat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjqtares 3. Mendimi përfundimtar i	0-10%	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë

		kryetarit			11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardëve minimalë kohorë	1. Të dhenat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dëdikohët çdo çështje	1. Të dhenat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë së standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë së standardi për shumicën e kategorivë të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë së standardi për gjysmën e kategorivë të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër së standardi për shumicën e kategorivë të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rëndimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësorë	1. Të dhenat statistikore 2. Vetëvlerësimi i	+99%	10	Tëj standardit : Nën 81%- 2 pikë

		gjqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit			Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë	
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1.Të dhenat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër së afati procedural për shumicën e katëgorivë të çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë së afati procedural për të gjitha katëgoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë së afati procedural për shumicën e katëgorivë të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë së afati procedural për gjysmën e katëgorivë të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër së afati procedural për shumicën e katëgorivë të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha katëgoritë e çështjeve – 15 pikë	
B. Aftësia	e	a. Numri mësatar i seancavë	1.Të dhenat statistikore	1-3 seanca	15	Numri mësatar i seancavë

gjqtares për të kryer procedural gjyqësorë	gjqësorë për çdo çështje dhe kryerja e veprimëve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	/Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë		dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi mesataren	16	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: Ë dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësorë	a. Rrëgullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: Ë dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Mëtodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarës: Ë dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarës	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshmë, ndëri dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhenat e Raportit të	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarës : Ë dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë

		ILDKPKI			
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuësë	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuësë: Ë dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tëjët i lartë i kërkesavë të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhenat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsidëruëshëm	15	Numri i kërkesavë të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tëjët i lartë – 3 pikë I pa konsidëruëshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PËRSONALË DHE ANGAZHIMI PROFËSIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				95	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Mëtodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparënca e komunikimit: Ë dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

		4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short			
	b. Rëspëktimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhenave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Rëspëktimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mësatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolëgët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhenat për verifikimin e ankësavë	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: Ë dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësorë	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhenat për verifikimin e ankësavë	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: Ë dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë

C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në vëprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhduës në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnimë të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Dokumentë të dorëzuara nga gjyqtarja	5-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës: (përiudha 3/vjëçarë) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhëqur kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarës 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucionë të tjera	Ka të dhena	5	Nuk ka të dhena – 3 pikë Ka të dhena – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarës në vëprimtari ndër-institucionalë për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në vëprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarës 4. Çdo e dhenë tjetër që trëgon ngritjen profesionale të gjyqtarës	Ka të dhena	5	Nuk ka të dhena – 3 pikë Ka të dhena – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjor akademike	1. Dosja personale e gjyqtarës 2. Çdo e dhenë tjetër që trëgon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhena	0	Nuk ka të dhena – 0 pikë Ka të dhena – 1 deri në 5 pikë

PIKËZIMI PËR KATËR KRITERËT E VLERËSIMIT	391
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

